



30 VJET NGA RIHAPJA E XHAMISË

„Ethem Beu”



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXIX i botimit
Nr. 01 (456)
Janar, 2021

ISSN 2226-7115



Artikujt

që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 29 vite "Drita Islame" / Dorian Demetja

6 Filloje nga e para / Qani Sulku

8 Lajme / Aktivitete



12 Di, por nuk do / Nuredin Nazarko


14 Koncepti i Kur'anit 2 / Ali Ynall

16 Vlera e sures Fatiha / Shkëputur nga libri "Tefsiri i sureve të shkurtra të Kur'anit", Botim i KMSH

18 Meditimi rreth krijimit të njeriut / Ebu Hamid El-Gazali r.a.

20 Umeti Islam si nocion dhe karakteristikat e tij / Semir Bodnar

22 Ymeti im është sikurse shiu i frytshëm, nuk dihet a është më i mirë fillimi apo fundi i tij / Abdulesamed Bushatiq



26 H. Hafiz Dr. Hasan Kaduku , Një hafiz Kur'ani, mjeku i parë stomatolog shqiptar / Genti Kruja


30 30 vjet nga rihapja e xhamisë "Ethem Beu" / Redaksia

31 Të edukosh me dhembshuri / Aisa Kokiqi

32 Në kërkim të një vaksine për COVID-19 / Aras Konjodhziç

34 Ndryshimi i njetit

38 Një traditë e bukur



“Drita Islame”

Në vitin 1967, Shqipëria u shpall shteti i parë ateist në historinë e njerëzimit, i cili kulmoi me aksionin e madh për çrrënjosjen e xhamive e kishave, duke i sjellë vendit një dëm të dyfishtë edhe për vlerat e pazëvendësueshme kulturore, historike e arkeologjike të këtyre objekteve. Nëpërkëmbja e të drejtave minimale demokratike e humanitare të qytetarit, zgjati gati pesë dekada. Me rënien e sistemit komunist, me ndihmën edhe të popujve miq, Shqipëria u integrua në pluralizëm. Më 1990, u rivendos liria e fesë. Institucioni i Komunitetit Mysliman, i sapongritur, paralelisht me punën e hapjes së xhamive, duke vlerësuar situatën, e pa si nevojë të ngutshme nisjen e botimeve, ku i jepej përparësi shtypit periodik.

Ka qenë traditë e kahershme që institucionet përfaqësuese të komuniteteve fetare, të kenë mjetet e tyre të komunikimit masiv, kryesisht ato të shkruara në formën e gazetës dhe revistës, si dhe së fundmi të radiove, faqeve të internetit, rrjeteve sociale, etj. Ditën e premte, më 10 janar 1992, doli numri parë i gazetës "Drita Islame". Kryeredaktor i gazetës u caktua Ismail H. Muçej. Autorë, të kudondodhur nëpër Shqipëri, i rritën pretendimet ndaj artikujve të tyre, për t'u paraqitur me tematikë të larmishme çdo herë më të përmirësuar. Dinamika e zhvillimit në drejtim të cilësisë së shkrimeve, u orientua në kahun e prosperitetit, së bashku me zgjerimin e rrethit të bashkëpunëtorëve.

Përmbajtja e gazetës karakterizohej jo vetëm nga botimi i mesazhit islam për një popull të etur për besim, por përmes analizave, sugjerimeve dhe kritikave të ndryshme, ka funksionuar edhe si një zë i elitës myslimane me besimtarët, shtresat e shoqërisë dhe institucionet publike e private, të gjitha këto në lidhje me çështje të nxehta që preknin realitetin shqiptar. Që në numrin e parë, gazeta shpalosi misionin e saj shoqëror dhe kombëtar, ku synonte zgjimin e ndërgjegjes fetare te besimtarët e saj në bazë të mësimave morale të Kur'anit, duke e zhveshur nga të gjitha mbresat e dëmshme të lëna nga ateizmi për afro gjysmë shekulli.

Në një moment kur Shqipëria po përballej me një nga krizat më të mëdha të periudhës paskomuniste, atë të firmave piramidale në vitin 1997, KMSH, përmes "Drita Islame", sqaroi pozicionin e saj ndaj kësaj çështjeje, duke i ofruar çdo besimtar të vërtetën

islame ndaj kamatës apo fajdesë: "Si fe humanitare që është, Islami e ndalon marrjen e interesit përkundrejt një huaje të dhënë dhe e konsideron atë si një akt që shkon në kundërshtim me atributin e Zotit", thuhet në një editorial të posaçëm të publikuar në shkurt të 1997-ës.

"Drita Islame", nëpërmjet mesazheve që përcjell, përmbledh jo vetëm spektrin fetar, por trajton edhe një sërë çështjesh problemore që kanë të bëjnë me edukimin, ekonominë, normat e sjelljes komunitare, çështje me karakter social e politik, etj. Nga një vështrim i thjeshtë që mund t'i bësh çdo numri të gazetës/revistës, vihet re një larmi e gjerë analizash mbi çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me besimin, artin, kulturën, kombin, etj. Mjafton të shfletosh faqet e gazetës/revistës dhe që nga viti 1992 e deri më sot, do të gjeësh tema nga më të larmishmet, të cilat synojnë lexues të profesioneve, etnive dhe besimeve të ndryshme. "Drita Islame" ka edhe një meritë tjetër, atë të kujdesit të posaçëm që ka treguar për të respektuar arritjet bashkëkohore të gjuhës sonë me komponentët e saj, që ne e konsiderojmë si një kontribut me vlerë në drejtim të kulturës gjuhësore në të shkruar, pse jo, edhe në të folur.

Duke filluar nga nëntori i vitit 2011, Drita Islame nisi publikimin e saj edhe përmes internetit. Në këtë mënyrë, ajo, përmes kanaleve virtuale, arriti të komunikojë me lexues përtëj "çdo kufiri" kohor apo hapësinor. Nëpërmjet adresës zyrtare të saj www.dritaislame.al, ajo përcjell te "vizitorët" jo vetëm informacion fetar mbi Kur'anin, hadithin, fikhun, por edhe zhvillime nga aktivitete dhe takime të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, tematika sociale mbi shoqërinë dhe familjen, komente, hapësirë feminare, njohuri mbi shëndetin, etj.

Në këtë fillimvit, "Drita Islame" mbushi 29 vjet veprimtari të jetës në shërbim të myslimanëve dhe të të gjithë qytetarëve të kombit tonë, pa dallim ngjyre, religjioni apo shtrese shoqërore. Kontributi dhe arritjet e "Drita Islame" nuk mbarojnë këtu; veprimtaria e saj është mirëpritur nga vetë lexuesit. Me rastin e 29 vjetorit të organit të shtypit "Drita Islame", vëmendje të posaçme e përgëzime, meritojnë të gjithë ata që, për të paraqitur idealet, mendimet apo rezultatet e kërkimeve të tyre studimore, zgjodhën "Drita Islame".

Fillojje nga e para



Edhe pse vitet ekin njëri pas tjetrit dhe, bashkë me kalimin e tyre, ngarkohemi me mëkate nga më të ndryshmet, kjo nuk duhet të na pezmatojë deri aty sa e brendshmja jonë të na thotë: Për ne nuk ka më shpresë për falje apo fshirje gjynahesh. Edhe pse mund të jemi zhytur në mëkate deri aty sa që mendojmë se do mbytemi nga çasti në çast, fakti që dita tjetër na gjen gjallë, kjo do të thotë se na është dhënë një mundësi e re për ta shpëtuar veten nga mbytja. Mjafton të mbushemi me optimizëm dhe me shumë vullnet e shpresë të madhe të Bujari (Allahu) i Cili fal kë të dojë, edhe pse shpina jonë, ndoshta mund të jetë aq e përthyer nga mëkatet, sa që mund të thyhet nga momenti në moment. Çdo ditë e re është një mundësi për t'u shkarkuar nga barra e të këqijave që na mendojnë prej kohësh. Nëse ndërgjegjja jonë na këshillon dhe na vë në lëvizje për të marrë; masa përmirësuese për gjendjen tonë, kjo është shenjë pozitive. Kjo tregon se akoma akrepat e zemrës tonë rrahin në drejtimin e duhur. Nëse ndërgjegjja na bren sa herë që gabojmë, ky është një tregues se natyrshmëria e humanizmi brenda nesh akoma jeton dhe do të na shtyjë patjetër drejt pendimit, ndërsa pendimi do të na shpjerë drejt gjetjes së mënyrave për ta shlyer gabimin nëpërmjet një pune të mirë.

Nëse dëshiron t'ia fillosh nga e para e të hedhësh mbrapa krahëve gjithçka të pahijshme, e cila të ka robëruar e të ka mbajtur peng për vite me radhë, bëje pa më të voglin hezitim, për sa kohë sytë e tu hapen në agimin e çdo dite. Në këtë rast, ti nuk duhet të shikosh e të meditosh rreth numrit të madh të gjynaheve që mund të kesh bërë në të kaluarën, por të meditosh rreth mëshirës së pakufishme të të Madhit Zot; rreth gjerësisë së faljes së Tij, e cila përfshin distancën midis tokës dhe qiejve dhe çka mes

tyre. Është gjynah më i madh të mendosh e t'i thuash vetes: "S'ka Zot që mund të më falë mua me kaq gjynahe sa kam bërë", sesa të gjithë të këqijat që mund të kesh bërë me dhjetëra vite me radhë. Duke menduar kështu, ti i hyn në hak Zotit tënd dhe nënvlerëson fuqinë e Tij të pamatshme. E ku e di ti se çfarë mund të bëjë Allahu i Plotfuqishëm?! A nuk është Ai që krijoi këtë botë dhe gjithçka që e mbush atë?! A nuk të krijoi dhe ty dhe e ishte paraprakisht në dijeni për gjithçka do të veprosh?! Sigurisht që po. E ku do t'ia dijë Ai për mëkatet e tua?! Mjafton që ti t'ia kërkosh faljen e tyre me ngashërim e përgjërime dhe me vendosmëri të pastër, që Allahu ta kuptojë se rob i Tij ka bërë kthesë të rëndësishme në jetën e tij dhe i ka dhënë përparësi Zotit të tij. Kjo tokë ka njohur mizorë e mizori që nuk përshkruhen dot me fjalë; ka dëshmuar krime e tmerre nga më të rëndat, por prapëseprapë ka pasur prej tyre që i kanë thënë vetes "MJAFT" me këto vepra shkatërruese dhe i janë kthyer të penduar sinqerisht të Vetmit, i Cili i pranon pendimet e robërve të Tij, dhe ia kanë nisur nga e para të mbarës, të mirës, të këndshmes, të pëlqyerës, të shpërblyeshmes, të lëvdUARës, duke u larguar me shpirt, zemër e vepër të urreyerës, të ndaluarës dhe të dënueshmes. Sado vite të kesh mbi supe, nuk je vonë për ta hedhur këtë hap, sepse do të jetë një hap vendimtar për të ardhmen tënde të pakthyeshme. Përderisa je gjallë, dije se Allahu të do, prandaj të jep akoma shans për të ndryshuar. Përndryshe mund të ta kishte bërë rrësk vdekjen, sapo ta kishte mbushur kupën e mëkateve dhe të të merrte për në botën e përtejme e të të dënonte siç do donte. Por jol Dashuria e Allahut për njerëzit është shumë herë më e madhe sesa dashuria e nënës për foshnjën e saj të porsalindur; është më e madhe sesa malli që djeg nënën që nuk

e ka parë djalin e saj prej vitesh. A do donte kjo nënë që djali i saj të hidhej në zjarr e të digjej i gjallë. Sigurisht që jo! Nëse kjo nënë nuk do njëherë, Allahu i Lartësuar nuk do njëqind mijë herë që krijesa e Tij e përsosur të meritojë si dënim Zjarrin e Xhehenemit dhe zemërimin e vet Krijuesit të saj. E gjithë jeta e njeriut është një mundësi e artë për të që të sigurojë një të ardhme të paqte e të lumtur. E ç'mund të dojë më tepër njeriu?! Por ja që ka njerëz që Ahiretin nuk e kujtojnë dhe për të as që mendojnë.

Vëlla i dashur dhe ti motër e nderuar! Është koha që të marrësh vendimin e duhur. Mos të të interesojë se çfarë mendon bota për ty, por ajo që duhet të të interesojë duhet të jetë se çfarë vlere dhe vendi ke tek Allahu. Mos i lër ditët të të ikin kot; mos i lër ditët të perëndojnë duke marrë; me vete mëkatet e tua; mos e lër veten të shtrihet netëve në shtrat të mbuluar me mëkate; mos! Nuk i dihet se cila mund të jetë dita jote e fundit, kështu që merre këtë këshillë vëllazërore dhe vëre në zbatim për të mirën tënde. Duke të këshilluar ty, së pari këshilloj veten time, sepse egoja e çdokujt e shtyn pronarin e saj drejt të keqes, përveç atij që ka merituar mbrojtjen e Zotit nga të ligat. Mos iu gëzo një viti që iku dhe u stërmbysh me veprat e tua të liga, por gëzohu që në jetën tënde vjen një tjetër vit dhe çdo orë e minutë të tij, mundohu ta shfrytëzosh për mirë. Dije se e mira nuk ka kufi, ashtu siç edhe e keqja nuk ka kufi. Kënaqe Zotin tënd. Le të jetë kjo aspirata jote, qëllimi yt më i lartë, ëndrra jote e vazhdueshme dhe ke për ta parë se fundi i kësaj rruge do të jetë i lumtur; fundi i kësaj rruge nuk mund të jetë asgjë tjetër përveç se Xheneti. Allahu na e bëftë rrësk të gjithëve ta meritojmë këtë shpërblim kaq madhështor, të premtuar për vepërmirët, e të jemi fqinj me prijësin tonë të nderuar, Muhamed Mustafanë. Amin!



1

TAKIM ME KREUN E BASHKËSISË FETARE ISLAME TË MAQEDONISË SË VERIUT

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim kreun e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, H. Hfz. Shaqir Fetai, i cili vizitën e tij të parë pas zgjedhjes në krye të BFI e zhvilloi në Tiranë, në selinë qendrore të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

H. Hfz. Fetai shoqërohej në takim nga Drejtori për Marrëdhënie me Botën Arabe pranë Rijasetit të BFI.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë do të vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë midis dy bashkësive tona në dobi të besimtarëve dhe përcimit të mesazhit paqësor të Islamit, theksoi ai ndër të tjera në fjalën e tij.

Z. Fetai falënderoi Kryetarin e KMSH për pjesëmarrjen në ceremoninë solemne të betimit të tij në 26 nëntor, në Shkup.





2

TAKIM LAMTUMIRE ME AMBASADORIN E POLONISË NË SHQIPËRI

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim lamtumire Ambasadorin e Polonisë në Shqipëri, z. Karol Bachura.

Kryetari Spahiu i shprehu atij vlerësimin për miqësinë që ka treguar ndaj Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe popullit tonë gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në Shqipëri.

Ambasadori Bachura, pasi shprehu kënaqësinë për misionin e tij në Shqipëri, si dhe për cilësinë e marrëdhënieve mes institucionit që ai përfaqëson dhe KMSH-së, shprehu edhe vlerësim të veçantë për kontributin që jep KMSH në harmoninë dhe dialogun fetar në Shqipëri, si një model tepër i çmuar.





3

KONFERENCA VIRTUALE E ORGANIZUAR NGA FEDERATA E PAQES UNIVERSALE ME QENDËR NË SHQIPËRI

Federata e Paqes Universale, me qendër në Shqipëri, zhvilloi konferencën virtuale me temë: "Udhëheqësit shpirtërorë, burim shprese dhe harmonie për njerëzit në kohë krizash".

E zhvilluar nëpërmjet platformës online "zoom", kjo konferencë mbledhi së bashku personalitete të ndryshëm dhe përfaqësues nga të gjitha komunitetet fetare të vendit tonë, veçojmë këtu Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu, pasi falënderoi organizatorët për zhvillimin e kësaj konference, u ndal në gjendjen aktuale nëpër të cilën po kalon jo vetëm vendi ynë, por edhe bota mbarë, duke e vënë theksin mbi gjendjen e krijuar nga Pandemia Covid-19 dhe pasojat që la tërmeti i 26 nëntorit të vitit të kaluar.

Kjo konferencë u zhvillua në kuadër të dhjetëra aktiviteteve të tjera të ngjashme që Federata e Paqes Universale ka organizuar gjatë muajit dhjetor në të 4 kontinentet, me qëllim përcjelljen e mesazheve të paqes, shpresës dhe solidaritetit për të gjithë njerëzit në mbarë botën.





4

TAKIM PUNE ME PREFEKTIN E QARKUT TIRANË, Z. TONI GOGU

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim pune Prefektin e Qarkut Tiranë, z. Toni Gogu. Në fjalën e tij, kryetari Spahiu, e uroi prefektin për marrjen e kësaj detyre dhe i uroi atij suksese në përmbushjen e përgjegjësiave. Më tej ai e njohu me kontributin e KMSH-së në kapërcimin e situatës së vështirë që krijoi tërmeti i 26 nëntorit në vendin tonë, si dhe të masave të ndërmarra në kuadër të ndërgjegjësimit dhe parandalimit të përhapjes së mëtejshme të pandemisë Covid-19. Një tjetër pikë, në të cilën u ndal kryetari Spahiu gjatë fjalës së tij, ishte bashkëpunimi i deritanishëm me prefekturën e Tiranës në shërbim të besimtarëve dhe qytetarëve të kryeqytetit.

Ndërsa z. Gogu, pasi e falënderoi kreun e KMSH-së për mikpritjen, vlerësoi kontributin e çmuar që Komuniteti Mysliman i Shqipërisë jep vazhdimisht në shoqërinë tonë për kapërcimin e situatave, si rasti i tërmetit dhe pandemisë dhe në çdo rast tjetër i çfarëdo natyre qoftë.



DI, PO NUK DO

Njeriu është i prirur drejt ecjes me kahe të kundërta. Shpesh paralele. Shpesh drejtime të kithëta. Akoma dhe më shpesh drejtime më pikëpërplasje të forta, që janë dëshmi e akullt mbi natyrën e karakterit të njeriut. Në këtë det të qetë e të shkulumëzuar noton anija e qenies njerëzore, në përpjekje për të gjetur limane ku të lëshojë spirancën. Sa kalon njëfarë kohe në qetësi, ndizet shpirti i aventurës dhe hidhet menjëherë në lundrim pa e ditur se me çfarë rreziqesh do të ndeshet. Për të ruajtur anijen të pacenuar dhe, ç'është më e rëndësishmja, për të mos u fundosur, nuk duhet të tërhiqemi nga lundrimi. Duhet të thellojmë dijet mbi detin, lundrimin, cilësinë e anijes. Te përballja me rrezikun ndryshojnë njerëzit nga njëri-tjetri, por ajo që i bashkon është: Di, po nuk do.

Këtu ndahen njerëzit nga njëri-tjetri. Di, po nuk do. Peshorja e lartësisë së vlerave dhe cilësisë së tyre.

Di të nxisë përçarje, po nuk do.

Di të vjedhë, po nuk do.

Di të thashethemnojë, po nuk do.

Di të humbasë nderin, po nuk do.

Di të zhvatë, po nuk do.

Di të mashtrojë, po nuk do.

Di të përbaltet, po nuk do.

Di të shkelë në dërrasë të kalbur, po nuk do.

Di të jetë zemërlig, po nuk do.

Di të helmojë jetën e tjetrit, po nuk do.

Di të jetë i egër dhe i pamëshirshëm, po nuk do.

Di të jetë fytyrëengjell me zemër djalli, po nuk do.

Di të shtypë të varfrin, jetimin, të dobëtin, të mjerin, po nuk do.

Di të ngulë thika pas shpine, po nuk do.

Di të jetë bukëshkalë, po nuk do.

Di të jetë mosmirënjohës dhe besëprerë, po nuk do.

Di të vjellë vrer, po nuk do.

Di të jetë pa skrupuj, po nuk do.

Di të jetë delenxhi e lafarak, po nuk do.

Di të jetë sahanlëpirës e puthador, po nuk do.

Di të jetë mashtrues kalibri, duke përdoruar të vërtetën e mirësinë si tunikë poshtë së cilës fsheh kamën e ligësisë, po nuk do.

Di të jetë i paditur, po nuk do.



Di të jetojë në limane të qeta, por është i dashuruar me detin dhe lundrimin.

Antipod i kësaj qenie është e njëjta qenie po në kahun e përkundërt. Edhe kjo qenie jo se nuk di se çfarë vlere kanë zgjedhjet që kryen, po nuk do të jetë në anën e lartësimi të zemrave dhe virtyteve.

Di të jetë fytyrëqeshur, po nuk do.

Di të jetë i drejtë, po nuk do.

Di të thotë të vërtetën, po nuk do.

Di të mos vjedhë, po nuk do.

Di të jetë i ndershëm, po nuk do.

Di të jetë mirënjohës, po nuk do.

Di të jetë i moralshëm, po nuk do.

Di të jetë zemërmirë, po nuk do.

Di të jetë i mëshirshëm dhe i butë, po nuk do.

Di të jetë i fjalës dhe i besës, po nuk do.

Di të jetë mikpritës dhe i respektuar, po nuk do.

Di të jetë në anën e së mirës dhe virtyteve, po nuk do.

Di të jetë qenie që jeton, po nuk do.

Di të vijë era parfum lulesh, po nuk do.

Di të lundrojnë mes dallgësh e ngushticash, po nuk do.

Ka zgjedhur të ngrohë vezët në furrikun e së keqes. Me vetëdije refuzon të mirën, pasi nuk ka qenie që të mos arrijë të kuptojë vijën ndarëse mes së mirës dhe së keqes. Zelltar në përmbushjen e dëshirave, që mbijnë si fara e sinapit dhe duhen ushqyer e mbajtur në jetë. Duke ushqyer gjërat e pavlera edhe vetë njeriu zhvlerësohet dalëngadalë, duke humbur trajtën njerëzore. E keqja që zgjedhin të ushqejnë zaptin zemrën dhe nuk lejon që të buisin farat e së mirës. Kjo është tragjedia. Dhe kur kjo tragjedi vihet në skenë, asgjë e bukur nuk mund t'i ofrohet publikut përveç pamjes së tmerrshme të shpirtit, që luan këtë rol, dhe mesazhit të kthjellët që të mos jetojë me një tragjedi të tillë.

I takon gjithsecilit nga ne që kur të mbërrijë në pikën ku ndahen kahet e lëvizjeve, di po nuk do, të peshojë mirë vendimin nga cili kah do ta mbajë udhën. Pjesa tjetër është përmbushje e vendimit. Rëndësia themelore i takon mendimit, pasi aktet janë të udhëhequra tërësisht prej tij. Të sfidojmë veten dhe të vrapojmë drejt kopshteve të bukura të refuzimit të së keqes.

KONCEPTI I KUR'ANIT 2



Kur'ani, nuk është vetë fjala e Pejgamberit por është libri i shpallur me anë të shpalljes nga Allahu. Ai, është mrekullia me e madhe që dëshmon Pejgamberine dhe në të njëjtën kohë nuk është vetëm për arabët. Deri në ditën e gjykimit ai do të sfidojë të gjithë njerëzit dhe xhinët që të mund të sjellin diçka të ngjashme. Ka një ritëm në leximin e pjesëve të sureve dhe ajeteve. Mes të gjitha burimeve dhe librave fetare, për gjatë gjithë historisë në aspektin e së vërtetës dhe unikes nuk mund të gjendet një shembull sikur Kur'ani. Në Kur'an as nuk është shtuar dhe as nuk është hequr ndonjë fjalë; por, vetëm ka disa ndryshime të vogla në mënyrën e të lexuarit, por kjo nuk ndikon në kuptimin e tij. Qasja, prezantimi dhe zgjidhja e çështjeve që Kur'ani ka arritur është plotësisht unike. Në Kur'an asnjë çështje nuk trajtohet në mënyrë sistematike siç ketë e bënë një kalamist (teolog), dijetar ose shkrimtar. Përkundrazi, Kur'ani ka një sistemim 'tasrif', e cila është një formë unike e të shprehurit. Tregon shumëllojshmëri, menjëherë i ndryshon temat, nga një çështje kalon tek tjera, kthehet ose përsëritet.

"Na, në këtë Kur'an, u shpjegojmë njerëzve gjithfarë shembujsh, por shumica e njerëzve, kurrsesi nuk duan të

besojnë." {El-Isra'e: 89}

"Thuaj: "Çka mendoni sikur t'jua merrte Perëndia të dëgjuar dhe të pamit dhe t'ua vuloste zemrat tuaja; cili zot,

përveç Perëndisë do t'ua kthente ato?" Shih si ua shpjegojmë Na dokumentet, e ata përsëri e kthejnë kryet." {El-

En'am: 46}

"Shih si ua shpjegojmë Na dokumentet [faktet], që të kuptojnë ata!" {El-En'am: 65}

"Kështu, Ne, në mënyrë të ndryshme i tregojmë dokumentet, për të thënë ata: "Ti i ke mësuar ato [prej librave të

mëparshëm]!" dhe t'ju shpjegojmë

Kur'anin njerëzve që dinë (të drejtën)." {El-En'am: 105}

Shfaqja e ndryshimeve të tilla në harmoni është për të treguar shenjat e Teuhidit. Mbi kuptimin e ajeteve që dhamë më sipër, Kur'ani miraton një shprehje kaq të larmishme dhe ata që e kundërshtojnë atë, akuzojnë Pejgamberin madje edhe Allahun. Por ai në të njëjtën kohë, ka për qëllim të gërmoj (sfidoj H. S) mendimin njerëzor. Kjo formë e të shprehurit, shpreh unitet në të ndryshueshmëti dhe harmoni në të shumtat. Kjo mënyrë e tregimit, në fakt, pasqyron renditjen e universit. Edhe në ambientin më të afërt të vetës tonë, në përballe me një ndryshueshmëri të

madhe dhe përballë dallimeve ne shohim një unitet të zakonshëm.

Kur'ani, përkthim i përgjeshëm i librit të universit, në këtë mënyrë na e reflekton organizimin e tij, dhe jo jetën në mënyrë të ndare në pjesë sikur sot. Mirëpo, na e paraqet si një tërësi. Suret e Kur'anit dhe renditja e ajeteve asnjëherë nuk ndjekin një radhë kronologjike, po ta shihni, një pjesë e ajeteve janë zbritur një nga një, edhe në Kur'an janë vendosur në këtë formë, mirëpo, menjëherë pas ajeteve njëra pas tjetrës ajete të tjera kane zbritur në tjetër kohë edhe janë me tema të ndryshme. Megjithatë, ndërmjet këtyre temave ka lidhshmëri shumë të ngushtë që nuk duhen të neglizhohen. Disa sure ose ajete edhe pse janë të gjata, disa janë më të shkurta. Një prej arsyeve të këtyre është se, në të vërtetë në Kur'an në çdo ajet ka një lidhje që nuk këputet njëra nga tjetra.

Në Kur'an, herë pas here lexuesit i vijnë shumë ajete sikur janë në kundërshtim me njëra-tjetrën; në të njëjtën kohë, neve nuk duhet të na befasoje mënyra e sistemimit 'tasrif-it' atë që e bëjnë të njohur sikurse te suret, edhe ajetet shihen sikur nuk kanë një lidhje me njëra-tjetrën. Aspektet që na duken të pa lidhura dhe mospërputhje me njëra-tjetrën, në të vërtetë nuk

janë. Kur'ani siç është shprehur me sipër, reflekton në brendësinë e universit, dhe neve na mëson sesi të kujdesemi dhe të afrohemi (sillemi) në jete, ndaj universit, apo ndaj gjerave. Sidoqoftë, ekziston një kontradiktë dhe mos lidhje në vete njeriun, i cili nuk integrohet (siç duhet H. S) me universin dhe me Kur'anin.

Për këtë arsye, nëse i afrohemi Kur'anit vetëm me aftësi (të zakonshme H. S) njerëzore, dhe pastaj pretendojmë në kuptimin e plote të Kur'anit apo të flasim mbi Kur'anin, atëherë kjo tregon pse se ai nuk kuptohet. Kur'ani ka zbritur në gjuhën arabe, dhe arabishtja në një kuptim për Kur'anin është bërë 'forma' e tij. Feja nuk është vetëm një filozofi e korrigjimit të mendjes, besimit apo teologjisë; por ajo merret edhe me trupin tonë, pra me gjithë ekzistencën tonë. [5] Në këtë këndvështrim, arabishtja është një element, faktor i Kur'anit. Kur'ani edhe pse ka zbritur në arabisht, kjo nuk do të thotë që vetëm arabet ta kuptojnë atë. Si fillim, për të qenë një fe kozmike duhet të ketë një gjuhë kozmike. Se dyti, zërat dhe fjalët e gjuhës së Kur'anit janë pjesë që nuk i ndahen shpalljes. Fakti se Kur'ani ka ardhur në gjuhën arabe, Kur'ani i ka dhënë shenjtëri gjuhës arabe. Kjo gjuhë e shenjtë shërben si një mjet kryesor për t'u përfshirë në një masë hyjnore. Por Kur'ani me arabishten që lexohet, pra në origjinalen e saj, mund të jetë Kur'an; por, Kur'anit ashtu sikur në përkthimet e gjuhëve tjera, që nuk i thuhet Kur'an, Kur'ani edhe në adhurime nuk lexohet në përkthime të gjuhëve tjera. Kur'ani ka kuptim brenda kuptimeve të tij; të zhytesh në këtë det kuptimesh në një fare mënyrë, është e mundur të njohësh shumë mirë gjuhën e tij. Pa e ditur arabishten mund të bëhesh një musliman i mire, por, pa e ditur arabishten Kur'ani shumë pak kuptohet.

Kur'ani në Islam është burimi i diturisë, ai nuk merret vetëm me

aspekte shpirtërore, por ai trajton edhe aspektet tjera si ahlakun (moralin), drejtësinë, filozofinë, madje ai është edhe burimi (nxitësi H.S) i diturisë mjekësore. Sipas një derminimi që ka bërë Bediuzamani qëllimet kryesore të Kur'anit i ka ndarë në katër objektiva, të cilat bazohen në udhëzimin e të gjithë njerëzve drejt së vërtetës: monoteizmi, pejgamberia/shpallja, ahireti, adhurimet dhe

drejtësia.

Në Kur'an të gjitha ajetet kthehen mbi këto katër themele, "e thata dhe e njoma", "e fshehur dhe e hapur, të përgjithshmet (ixhmaili) dhe detajet (tafsili)" strehohen në Kur'an. P.sh nevoja mrekullitë e Pejgamberit ose rruga e historisë së haditheve, ose nevoja perms rruhes se shenjave, permendenja e diturive soe rezidenca(faze) e fundit e diturise, te flasesh per etapet eshte istiradi, domethene "per rastin" dhe eshte menduar per qellimet kryesore qe kemi pemendur.

Brenda këtyre katër qëllimeve kryesore, Kur'ani përmban të vërteta ligjore, parime të besimit, rregulla për rregullimin e jetës njerëzore në tokë, jetën e ahiretit, xhennetin dhe xhehenemin, në veçanti shpjegime të lidhura me banoret e xhennetit dhe xhehenemit, shkurtimisht, ka nivele kuptimore që mund të përfshijë jetën dhe mendimet e çdo personi. Kur'ani është një shërim; kur e lexon të mbush me shërim, dhe mbi të gjitha, qoftë ajo nëse është individuale ose sociale, jep shërim në gjithë sferat e jetës. Kur'ani është një dituri universale, një dituri që mund ta kap njeriu, një histori, një ligj. Është dërguar në mënyrë që të gjykojë mes njerëzve. Jo vetëm për një popull apo kohë të caktuar, por këto janë norma që duhet t'i ndjek çdo njeri si dje dhe sot. Ai përmban parime, dispozita që duhen të zbatohen.

Nuk do të kalojmë pa përmendur disa hadithe në lidhje me Kur'anin;

Kur'ani është me i dashur te

Allahu më shumë se të gjithë ato që gjenden në Tokë dhe në qiell.

Superioriteti i Kur'anit mbi fjalët e tjera është sikur epërsia e Zotit të Madhëruar, mbi krijesat e tij. Kur'ani, është një gjykim i prere që e ndan të kotën me të vërtetën. Kush e le atë për shkak të mendjemadhësisë (tiranisë) se tij, Zoti do ta thyej atë nga qafa e tij. Është historia e atyre që kanë qenë para jush dhe lajmi i atyre pas jush, dhe tek ai është gjykimi i çështjeve mes jush. Kushdo qoftë që kërkon të drejtën pos tij, Allahu atë e le në humbje. Ai është litari më i sigurt i Zotit. Ai është Përkujtuesi i Urtë (dhikri hakim). Ai është rruga me e drejtë. Ai që dëshirat nuk i devijon, gjuhët nuk i ngatërrohen (i pa gabueshëm), ai që me të nuk ngopen dijetaret, që nuk vjetrohët nga përsëritja e tepërt, një libër që me të gjitha anët është i admirueshëm. Ai është një libër që kur edhe xhindet e dëgjuan atë thanë: "Dhe ne, sapo e dëgjuam udhëzimin (Kur'anin) i besuam atij, 'nuk e morën vetën duke e thënë ketë, të gjithë ata që kanë folur duke u bazuar tek ai kane thënë të vërtetën, ai që punon me Te ka fituar sevap, ai qe

ka gjykuar me të ka bërë drejtësi, dhe ai qe ka thirrur drejt tij ka bërë thirrjen e sigurtë.[6]

Edhe pse vepra Usul-i Kaffi e Kulejnit nuk bënë pjesë në burimet e hadithit të Ehli Sunneti në të ekzistojnë gjithashtu thëniet e me poshtme rreth Kur'anit, që i atribuohen Pejgamberit tonë:

O ju njerez! Ju jeni në një botë të kompromiseve dhe në një udhëtim që do ja ktheni shpinën. Shkuarja e juaj është e shpejte, siç e patë, dita dhe nata, dielli dhe hëna çdo të re po e vjetron, çdo e largët po afrohet dhe çdo premtim po vjen e po realizohet, përgatiteni gjuhën tuaj për largësinë e vendit ku do të shkoni. Ne ketë rast, Mikdad bin Esved duke u ngritur iu drejtua Pejgamberit: çfarë do të thotë botë kompromiseshe?


Është botë e arritjeve dhe

ndërprerjeve, atëherë kur fitnet ju mbulojnë sikur errësira natën mbahuni për Kur'anin. Sepse Ai është ndërmjetim, shërimi i tij është një shërim i sigurt, është një force e verifikuar, kush e njeh atë si parësor, do ta nderojë me Xhennet, edhe me detaje ka shpjegime te qarta në të. Është fjalë e vërtete, nuk është lojë, në të është edhe e jashtmjja edhe e brendshmjja, sa i përket se jashtmes ka gjykim, dhe asaj se brendshmes dituri. E jashtmjja e bukur e bukur, e brendshmjja e thellë e thellë...Tek Ai gjenden dritat e së vërtetës dhe urtësisë. Është dëshmi e zgjuarsisë për ata që duan te dinë namin e tij, kushtoni vëmendje dhe jini të kujdesshëm, me të shpëtohet nga rreziku dhe zhdukja. S'ka dyshim se meditimi, është zemra e atij që sheh, njëjtë sikur ai që është pronar i dritës që shëtit nëpër errësirë, qëndroni mbi të mirën dhe pritshmërit le të jenë të pakta. [7]

Ne temen e Kur'anit si fjale permbyllese, le te japim gjithashtu pershkrimin e Kur'anit qe ka bere Bediuzaman Said Nursi, i cili i ka kushtuar jeten per te kuptuar te vertetat e Kur'anit ne kohën e tij dhe shekujve te ardhshëm: Kur'ani është përkthyesi para-përjetshëm i librit të fuqishëm të universit; interpretuesi përjetshëm i gjuhëve të ndryshme që recitojnë vargjet e krijimit; komentatori i librit të Botëve të Dukshme dhe të Padukurave; zbuluesi i thesareve të emrave hyjnorë të fshehur në qiej dhe në tokë; çelësi i të vërtetave që fshihen nën vijat e ngjarjeve; gjuha e Botës së Padukshme në Botën Manifestuese; thesari i favoreve të përjetshme të më të Mëshirshmit dhe të adresave pararendëse të atij Më të Shenjtit, që vijnë nga Bota e Padukshme përtej velit të kësaj Bote Manifestuese; është dielli, themeli dhe plani i botës shpirtërore të Islamit; harta e shenjtë e botëve të ahiretit; fjala shpjeguese, ekspozimi i kthjellët, prova vendimtare dhe interpretuesi i qartë

i thelbit hyjnor, atributëve, emrave dhe funksioneve; është instruktori i botës së njerëzimit; drita dhe uji i Islamit, makroantroposi; (mençuria e vërtetë e njerëzimit) udhëzuesi dhe udhëheqësi i vërtetë që nxit njerëzimin për prosperitet dhe lumturi; është edhe një libër ligji, edhe një libër lutjesh, edhe një libër me mençuri, edhe një libër adhurimi, edhe një libër urdhri dhe thirrje, edhe një libër thirrjeje, dhe një libër mendimi; është një libër i shenjtë unik, gjithëpërfshirës, që përfshin shumë libra, të cilëve mund t'u drejtohen nevojat e mbarë njerëzimit; është një shkrim i shenjtë i zbuluar që i ngjan një biblioteke të shenjtë që ofron traktate të përshtatshme për të gjitha mënyrat e ndryshme dhe shtigjet e ndryshme të të gjithë shenjtoreve dhe të vërtetëve dhe të mençurve dhe të diturve, i cili është i përshtatshëm për ndriçimet e secilës mënyrë dhe e ndriçon atë, dhe është i përshtatshëm për rrjedhën e secilit shteg dhe e përshkruan atë. Meqenëse Kur'ani ka ardhur nga Froni i Lartë dhe emri më i madh, dhe nga shkalla më e lartë e secilit emër, është Fjala e Allahut (në lidhje me të qenit i Tij Zot dhe Mbështetës i të gjitha botëve) është një dekret hyjnor përmes titullit të Tij të Zotit të të gjitha qenieve; është një adresë në emër të Krijuesit të qiejve dhe të Tokës; është një bisedë në lidhje me dominueshmërinë absolute (është një diskurs para-i përjetshëm për shkak të sovranitetit hyjnor universal;) është një fletore e favoreve të Më të Mëshirshmit nga pikëpamja e mëshirës hyjnore gjithëpërfshirëse; është një koleksion adresash në fillim të të cilave janë shifra të caktuara që lidhen me madhështinë e madhështisë hyjnore; dhe përmes prejardhjes së tij nga gjithëpërfshirja e emrit më të madh, ai është një shkrim i shenjtë i plotë me mençuri që shikon dhe inspekton të gjitha anët e Fronit të Lartë.





بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ
وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ
وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ
وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ
وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ
وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ
وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

VLERA E SURES

Fatiha

1. Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) ka thënë: "Surja Fatiha është shërim për çdo sëmundje."

2. Në një hadith tjetër thotë: "Surja Fatiha, është surja më e madhe e Kuranit."

3. Në një tjetër transmetim thotë: "Mua më është dhënë surja Fatiha dhe fundi i sures Bekare nga një thesar poshtë Arshit."

4. Transmeton Enes b. Malik (r.a.) nga i Dërguari i Allahut (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) se ai ka thënë: "Nëse lexon suren Fatiha dhe Kul Hu-Allahu Ehad, kur shtrihesh për të fjetur, je i ruajtur nga çdo gjë përveç vdekjes."

5. Ebu Said ibnu-Mual'a (r.a.) tregon: "Unë po falja namaz në xhaminë e Profetit. I Dërguari i Allahut (alejhi selam) më thirri, por unë ngaqë isha në namaz nuk iu përgjigja. Pastaj i shkova pranë duke i thënë: Po falja namaz o i Dërguari i Allahut (ngaqë nuk iu përgjigja për këtë arsye kërkova falje). I drejtuar nga unë më tha: A nuk thotë Allahu në Librin e Tij fisnik "O besimtarë! Përgjigjuni Allahut dhe Profetit kur t'ju thërrasë?!", pastaj shtoi e më tha: "A ta mësoj suren më të madhe (nga pikëpamja e shpërblimit) të Kuranit para se të dalësh nga xhamia?", dhe më kapi prej dore. Kur po dilte nga xhamia i thashë: A nuk më thatë se do të më mësonit suren më të madhe? Profeti (alejhi selam) më tha: "Ajo sure është Elhamdu lilahi Rabi'l-alemin, që (lexohet vazhdimisht në namaz) ka shtatë ajete (seb'a methanij) dhe është Kurani fisnik që më është dhënë mua."

6. Tregon Ibn Abbas (r.a.): Xhebraili (a.s.), kur ishte ulur pranë Profetit (s.a.s.), dëgjoi nga lart një zë të ngjashëm me zhurmën e derës. E ngriti kokën sipër dhe tha: "Në qiell u hap një derë, që nuk ishte hapur asnjëherë më parë deri sot". Në atë çast nga ajo derë zbriti një engjëll. Xhebraili (a.s.) foli sërish: "Në tokë zbriti një engjëll, që nuk kishte zbritur asnjëherë më parë". Engjëlli përshëndeti Profetin (s.a.s.) me selam dhe i tha: "Po të jap sihariqin e dy dritave që të janë dhënë Ty. Këto, nuk i janë dhënë asnjë profeti para Teje: Njëra nga këto është surja Fatiha, dhe tjetra pjesa e fundit e sures Bekare.

Për çdo shkronjë që lexon prej tyre do të kesh shpërblim shumë të madh".

7. Sipas një transmetimi Hasanu'l-Basri ka thënë: Allahu i Lartë ka zbritur njëqind e katër libra. Dijen e këtyre librave e ka përmbledhur në katër libra, dhe dijen e këtyre katër librave e ka përmbledhur në Kuran. Dijen e Kuranit e ka përmbledhur në suret e shkurtra (mufassal) dhe, dijen në suret e shkurtra e ka përmbledhur në Ummu'l-Kuran, Fatiha, ndërsa dija e Fatihas është përmbledhur në këto dy fjalë: "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë". E gjithë dija e zbritur në librat e shenjtë është përmbledhur në këto dy fjalë.

Fatihaja, duaja më e bukur

Kur duam të bëjmë dua, duke u nisur nga një hadith profetik, këndojmë suren Fatiha. Pastaj themi me këtë kuptim: "O Zoti im, Fatihaja është pretekst shërimi, dhe Ti je Shërues, vetëm Ti jep shërim. Nuk ka kush tjetër që të japë shërim veç Teje e, nuk ka shërim tjetër veç shërimit tënd. Më shëro nga sëmundja, ma largo dhimbjen. Më mundëso shërim të plotë, që të mos mbesë asnjë shenjë sëmundjeje."

Fatihaja është duaja më e bukur. Nëse këndohet me zemër të singertë, me lejen e Zotit bëhet shërim për çdo sëmundje. Në fakt, një nga emrat e kësaj sureje është edhe Shafije. Përveç këtij emri ka mbi njëzet emra të tjerë. Për shembull: Fakti që këndimi i saj në namaz është vaxhib, quhet Suret'u's-Salat; duke qenë e vetëmjaftueshme quhet Uafije dhe Kafije; duke qenë si origjina e përmbledhja e çdo sureje, quhet edhe Ummu'l-Kitab ose Esas.

Po ashtu, për largimin e çdo sëmundjeje e shqetësimi mund ta këndojmë këtë sure e të themi "Zoti im, kjo sure është Kafije. Me lejen Tënde është e mjaftueshme për çdo shqetësim. Ti je i Mjaftueshëm. Për hatër të kësaj sureje që këndova, më ndihmo në problemet dhe shqetësimet e mia."

Shkëputur nga libri

**"Tefsiri i sureve të shkurtra të Kuranit",
Botim i KMSH.**

MEDITIMI RRETH

krijimit të njeriut

Në njërën anë të ashtit Allahu krijoi zgjatje që del jashtë, e në ashtin tjetër krijoi gropë, ku ajo zgjatje nga ashti i parë përshtatet, me qëllim që eshtrat të lidhen mes vete. Kështu, kur njeriu dëshiron të lëvizë një pjesë të trupit të vet, nuk pengohet. Po të mos kishte ndarje mes eshtrave, njeriu nuk do të mund të lëvizte.

Gjithashtu, shiko eshtrat e kokës, se si Allahu i Lartmadhëruar aty i bashkoi pesëdhjetë e pesë eshtra, të formave dhe dukjeve të ndryshme. I bashkoi njëri me tjetrin, duke i dhënë kokës formën që ti e sheh. Në mesin e tyre janë gjashtë eshtra të veçanta të kafkës. Pastaj katërmëdhjetë eshtra për nofullën e epërme dhe dy për të poshtmen. Eshtrat të tjera janë dhëmbët; disa të gjatë, për përthypje, të tjerët të mprehtë, për prerje.

Shih qafën, që është si mbajtëse

e kokës, e përbërë nga shtatë rruazat e qafës. Në to ka lakesa, thellime, ngushtime, që rruazat të lidhen njëra me tjetrën, e të flasim për urtësitë edhe për formën e tyre, do të zgjatej shumë.

Më pas Allahu i Lartmadhëruar e vendosi qafën në shpinë. Nga pjesa e poshtme e qafës ka vazhduar me unazat e shtyllës kurrizore, e më pas me tri pjesë të ndryshme. Më pas, me rruazat e bishtit, që gjithashtu i ka tri pjesë. Më pas e lidhi kurrizin me eshtrat e gjoksit, të kraharorit, duarve, prapanicës, kofshëve, këmbëve dhe gishtave të këmbës.

Nuk do të vazhdojmë e t'i numërojmë të gjithë eshtrat. Totali i eshtrave në trupin e njeriut është dyqind e dyzet e tetë, duke mos llogaritur eshtrat e vogla, të ndara mes tyre me zbrazëtira. Shih si Allahu i Lartmadhëruar i krijoi të gjitha këto nga një pikë e

parëndësishme e farës (spermës)!

Qëllimi i përmendjes së eshtrave nuk është që të dihet numri i saktë i tyre. Ajo dituri i takon mjekëve, atyre që e njohin anatominë. Qëllimi është të mendohet në renditjen e tyre, dhe në Krijuesin e tyre, si i renditi, i bëri që të jenë të ndryshme në formë dhe madhësi, dhe si ka vendosur që të jenë pikërisht në këtë numër, sepse po të rritej numri i tyre vetëm me një, njeriut do t'i duhej ta largojë atë asht të tepërt. E sikur t'i mungonte vetëm një, do të ishte kjo e metë që duhej plotësuar. Mjeku, përmes kontrollit, e cakton se si duhet kompensuar ajo e metë. Mjeku i merr këto në shqyrtim me qëllim të shërimit. Kurse personi mendjemprehtë aty sheh dëshmitë e madhështisë së Krijuesit, i Cili u ka dhënë formën. Mes këtyre dy shikimeve dallimi është shumë i madh.



BISMIL LAHIR-RAHMANIR RAHIM

(Me Emrin e Allahut, Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit)

UMETI ISLAM SI NOCION DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ

Nëse do të bëhej e mundur për ne që të pyesnim disa individë në shoqërinë tonë rreth "Umetit islam sot", përgjigjet e pritura do të ishin pyetje të ngatërruara të vëna përballë njëra tjetrës, të tilla si: "Ku është umeti islam?!", "A vazhdon të ekzistojë?!", "Ose ato përgjigje do të ishin pohime dekurajuese e të pashpresa, të tilla si: "Umeti islam është i copëtuar dhe i përçarë...", "Umeti islam po vuan prej një situatë dobësie dhe poshtërimi...", "Umeti islam ka rënë nën sundimin e armiqve të tij...", "Umeti islam nuk ekziston më", "Sepse myslimanët nuk u kapën pas fesë së tyre dhe nuk u bënë të bashkuar nën mbrojtjen e parimeve të saj...". Këto janë shprehje që i lexojmë çdo ditë në ato çfarë shkruhen; i dëgjojmë në mjetet e informimit si dhe nga gojët e njerëzve në vendtakimet e tyre. Ata i shprehin këto për shkak të humbjes së shpresës së tyre lidhur me realitetin e sotëm të umetit islam. Ata konfirmojnë situatën e rëndë të umetit dhe rrezikun e përkeqësimit të sëmundjes në gjymtyrët e tij. Ndoshta ne nuk ndryshojmë shumë për sa ka të bëjë me disa prej këtyre mendimeve, të cilat arrijnë shkallën e konsensusit në një nivel të caktuar prej niveleve të leximit të realitetit, por ama një vështrim i dytë nuk do t'i jepte rëndësi më të pakët; kjo nuk do të mund t'i fshihej as prej vetëdijes së përgjithshme. Kjo është kriza jonë në perceptimin e nocionit të umetit islam dhe të kuptimeve të besnikërisë

ndaj tij, të përkatësisë dhe aderimit tek ai, si dhe të detyrave ndaj tij. Kjo krizë nuk është më e vogël se kriza që po përjeton ky umet sot. Madje mund të thuhet se ndodhet një lidhje shkakore, e cila nuk mund të mos vihet re, që bën lidhjen mes dy gjërave: "Ç'është umeti islam në zanafillë?", "Nga se përbëhet?", "Cila është lënda e tij?", "A nuk është secili mysliman guri-tulla më e vogël në strukturën e tij?". A nuk nënkupton kjo dhe a nuk kërkon lidhjen e drejtpërdrejtë - kur flitet për umetin islam dhe për problemet e tij mes individit dhe komunitetit, mes gjendjes së myslimanit dhe realitetit të umetit të tij dhe mes pjesës dhe të tërës - ashtu siç nënkupton e kërkon aspiratën dhe ngulmimin për njohjen e këtij umeti lidhur me bazat e strukturës të tij dhe me karakteristikat e tij dalluese, të cilat mund të jenë, në ndonjë mënyrë, njëri prej faktorëve i cili ia solli këto sfida për t'u përballur? Aspirata i ngjason shfaqjes së dëshpërimit dhe të pikëllimit për gjendjen e tij.

Pikënisje të këtilla, në përfytyrimin tonë, janë hyrjet që, për përgjigjet e tyre, kërkojnë medoemos zgjidhjet e parashtruara, madje pyetjet alternative. Gjithkush është i ftuar që të kontribuojë në bërjen e tyre dhe të ketë parasysh se këto pyetje duhet të jenë shtytësi për njohjen, studimin dhe kërkimin lidhur me alternativat e parashtruara të së ardhmes për umetin tonë, domethënë, para së

gjithash, për ne, prej pikëpamjes së përkatësisë parimore, aktuale dhe të vazhdueshme të umetit islam.

1. BAZAT E NGRITJES SË UMETIT NË ISLAM

Nocioni i ngritjes së umetit në islam ndërtohet mbi tre bazamente. Nuk do të ishte e lehtë që ato bazamente të perceptoheshin veçse duke qëndruar tek ato, jo thjesht duke përshkruar bazat dhe themelet mbi të cilat ngrihet struktura e umetit mbi dy aspektet e të menduarit dhe të përvojës historike, por sepse këto bazamente janë pjesë e pandashme e vetë natyrës thelbësore të umetit dhe e elementeve përbërës të strukturës së tij në të shkuarën, në të tashmen dhe për vazhdimësinë e tij në të ardhmen. Ato janë:

A) BAZA KULTURORE

Kjo përfaqëson bazamentin e strukturës së umetit islam. Duke u nisur nga kjo, ripërtërihen natyra thelbësore e tij, referimi, kriteret, standardet si dhe identiteti i tij. Kjo është pikërisht ajo që e shpjegon mesazhin e umetit islam, duke u mbështetur mbi burimet origjinale të kulturës islame të cilat përcaktojnë akiden, shariatën dhe sistemin e vlerave, të moraleve dhe të etikës. Duke iu referuar këtyre burimeve, ne perceptojmë se umeti islam është një nocion të cilin e ka themeluar Kur'ani Fisnik, "Dhe me të vërtetë ky umeti juaj është një umet i vetëm" (Kur'an, 23:52). Pastaj ai kaloi

në Sunetin Profetik te niveli i realitetit, i cili përfaqëson "Modelin Institucional". I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed a.s., e themloi bërthamën e umetit islam në Mekë prej një grupi sahanësh, të cilët i besuan atij dhe e ndoqën para se të vinte modeli praktik nëpërmjet "Dokumentit Kushtetues" në "Konventën Profetike ose në Fletën e Medinës", në të cilën erdhi sa vijon: "Ky është një dokument (marrëveshje) prej Muhamedit, Profetit, mes besimtarëve dhe myslimanëve prej Kurejshit dhe Jethribit (Medinës) dhe prej atyre që i ndoqën ata, u kapën pas tyre dhe luftuan së bashku me ta, se ata janë një umet i vetëm pa njerëzit (duke i përjashtuar njerëzit e tjerë)". Më vonë nëpërmjet veprave dhe fjalëve profetike, të cilat i dhanë bashkësisë islame në Medinë, pas Hixhretit, karakteristikat e umetit të vetëm të konsoliduar me lidhjet e akides, të idesë, të unifikimit të vlerave, të mesazhit, të projektit civilizues dhe të hapjes në një shtrirje të cilën nuk e përkufizon asnjë racë, asnjë ngjyrë, asnjë gjuhë dhe asnjë hapësirë gjeografike, përveç asaj që është prej imanit në parimet e këtij umeti dhe obligimit për t'iu përmbajtur autoritetit të tij të themeluar mbi shariat. Kjo e bën realitet unitetin e perceptimit për gjithçka që lidhet me këtë autoritet referimi, si bazë e respektit të asaj që buron prej parimeve dhe prej dispozitave që përfaqësojnë një sistem të integruar të etikës individuale dhe kolektive në mënyrë të barabartë. Me këtë shkallë qartësie ishte aludimi profetik në fjalën "Fletë". Sigurisht, çfarëdo mendimi të ndryshëm që të keni për diçka, ju duhet t'ia referoni Allahut xh.sh. dhe Muhamedit a.s. për themelimin e unitetit të referimit i cili përbën elementin më të rëndësishëm të identitetit të umetit islam, që "Beson në Allahun si Krijues, në Islamin si Fe, në Muhamedin a.s. si Pejgamber dhe i Dërguar, dhe në Kur'anin si Libër..." Realiteti është se kjo lidhje kontraktuese kulturore ka rolin e saj themelues në këtë identitet, ashtu siç u përmend më lart. Por, vetë ky bazament, në qoftë se do të

mbetej si një akide e përbashkët në zemrat e disa njerëzve dhe si një ide në mendjet e tyre, do t'u jepte atyre përgjigje ekzistenciale (ontologjike) për pyetjet rreth gjithësisë, jetës dhe njeriut, duke mos u shtrirë e zgjeruar tek aspekti praktik i jetës së tyre sipas mekanizmit të qëndrueshëm e të përhershëm, të cilat i themloi shariat me qëllim që elementet e identitetit dhe fuqia e hallkave të mbeten midis individëve brenda umetit. Sigurisht, mes myslimanëve, në kuadrin e akides së vetme, ndodhi largimi nga njëri-tjetri dhe ftohja të cilat nuk do të mund të përfytyroheshin veçse duke sjellë ndërmend ecjen (përparimin) e popujve dhe të shoqërive të tjera tek të cilat erdhën profetësitë dhe vijuan pandërprerë kumtuesit e teuhidit (njësimi të Krijuesit). Pastaj sa herë që kalonte një periudhë e gjatë apo e shkurtër kohe, duke kërkuar justifikime materiale e praktike për identitetin, u futën tek ata përçarja dhe sektarizmi; ata patën pikëpamje të kundërta, madje luftuan kundra njëri-tjetrit edhe rreth konceptimeve të ndryshme të besimit të përbashkët.

Realiteti është se umeti islam gjen në burimin e tij origjinal atë çfarë ne mund ta quajmë "përsëritje e vazhdueshme e prodhimit" të elementeve të unitetit, në nivele të ndryshëm, duke filluar nga bërthama e shoqërisë [familja] dhe duke arritur në nivelin e umetit më të madh islam, dhe duke kaluar në nivelet e të gjithë shoqërisë njerëzore. Ndoshta ky mekanizëm unifikues i vazhdueshëm duket më i qartë se ai që ndodhet në dy bazamentet shoqërore dhe ekonomike të ngritjes së umetit.



B) BAZAMENTI SHOQËROR I UMETIT ISLAM

Në qoftë se lidhjet njerëzore janë pikërisht ato që e themelojnë shoqërinë, atëherë ajo, në realitet, nuk përbëhet nëpërmjet numrave të mëdhenj prej individëve, sado që të arrijnë në numër, por veçse nën mbrojtjen e rrjetit të lidhjeve nryjë mes tyre, të cilat përfaqësojnë kushtin e ngritjes së shoqërisë dhe, në të njëjtën kohë, realitetin e saj. Duke u mbështetur mbi këtë bazament dalin në pah dispozitat e sheriatit të lidhura me aspektin shoqëror dhe të ngritura për vazhdimësinë dhe përjetësimin e lidhjeve mes individit mysliman dhe individëve të tjerë të Shoqërisë Islame, të cilën e bashkon dhe unifikon imani i përbashkët nëpërmjet elementeve themelore të Islamit [unitetit të referimit], sido që ta merrnin këtë iman, qoftë si dimension kontraktues kulturor që lidhet me myslimanin, ose si dimension civilizues lidhur me jomyslimanin brenda Shoqërisë Islame. Në përputhje me këtë, të drejtat e myslimanit ndaj myslimanit u shtrinë tek të gjitha aspektet e jetës shoqërore. Si rrjedhojë, gjasat e qëndrueshmërisë së lidhjes mes individëve të Shoqërisë Islame janë më të mëdha se çdo gjasë tjetër nën hijen e vlerave të kundërta. Kjo është për arsye se vetë natyra e zbatueshmërisë në Islam bën detyrim vazhdimësinë e takimit së bashku, gjë e cila bën të mundur forcimin e lidhjeve: "Pesë kohët e namazit në xhami, përshëndetjen me selam në fund të çdo namazi në nivelin e afërsisë dhe të fqinjësisë; bën detyrim takimin javor në nivel lagjeje; dy takime vjetore në dy faljet e Festave të Bajrameve në vendfaje të përbashkëta në nivel qyteti ose fshati; dhe takimin botëror të Haxhit, i cili e detyron atë që është në gjendje, qoftë edhe vetëm një herë në jetën e tij në nivelin e umetit islam". Sa më shumë që të ngushtohet rrethi shoqëror, aq më e madhe do të ishte kërkesa për forcimin e lidhjes. Atëherë ngritja shoqërore në Islam themelohet mbi bazat e farefisnisë, afërsisë dhe fqinjësisë. Ato janë lidhjet themelore në çdo ngritje shoqërore të bashkëlidhur dhe të shëndetshme. "Komshinjtë janë tre llojesh: Një komshi ka vetëm një të drejtë të vetme; një komshi tjetër ka dy të drejta; dhe një tjetër ka tre të drejta. Atëherë, komshiu që gëzon tre të drejta është komshiu mysliman dhe me lidhje farefisnie; ai gëzon të drejtën e fqinjësisë, të drejtën e Islamit dhe të drejtën e farefisnisë. Ndërsa ai që ka dy të drejta është komshiu mysliman, i cili gëzon të drejtën e fqinjësisë dhe të drejtën e Islamit. Kurse lidhur me atë që ka vetëm një të drejtë të vetme, ai është komshiu mushrik-politeist". (Këtë Hadith e transmetojnë Bezzari dhe Ebu Nuajm.) Kjo është krahas asaj që i është ngarkuar shoqërisë prej përgjegjësive të pajtimit midis dy kundërshtarëve në të gjitha nivelet, ashtu siç është rasti, për shembull, në "administratën publike" lidhur me mosmarrëveshjet bashkëshortore nëpërmjet dy gjykatësve. "Në qoftë se keni frikë se prishen marrëdhëniet mes atyre të dyve (dy bashkëshortëve), caktoni dy gjykatës, një nga familja e tij dhe një nga familja e saj. Në qoftë se ata të dy dëshirojnë pajtimin, Allahu do të bëjë të mundur pajtimin e tyre"

(Kur'an, 4:35). Duke u bazuar mbi atë që u fol më lart, lidhur me shtrirjen e konceptit të përkatësisë së Umetit Islam, duke përfshirë idenë e "përkatësisë civilizuese" e cila themelohet nga jeta dhe vlerat e përbashkëta shoqërore, si dhe nga uniteti i përvojës historike të individëve brenda një shoqërie të vetme, madje edhe sikur të kishte në mesin e tyre një minoritet që nuk i përket fesë së tyre, përkatësia e tij ndaj umetit do të ishte nëpërmjet lidhjes kulturore dhe të Civilizimit Islam, të cilat përfaqësojnë një kuadër të jetës së përbashkët mes tyre si minoritetet dhe shumicës myslimane. Me qëllim që të mos na shmangin shembujt e grumbulluar historikë prej rrjedhës së qëndrimeve, të cilat mishëruan bazamentin e fortë shoqëror të jetës së këtyre të gjithëve brenda kuadrit të umetit gjithëpërfshirës..., ne duhet të kapemi fort pas origjinës "kulturore" të jetës shoqërore në këtë nivel nëpërmjet bashkëpunimit njerëzor të përcaktuar me qartësi në Kur'anin Famëlartë: "Allahu nuk ju ndalon që ju të bashkëpunoni me drejtësi e mirësi me ata të cilët nuk ju luftuan ju për çështje të fesë dhe nuk ju dëbuan nga shtëpitë tuaja. Vërtet që Allahu i do ata që bashkëpunojnë me drejtësi" (Kur'an, 60:8). Treguesi i dy fjalëve: "Teber-ruuhum" (T'i nderoni ata); El-birr: (maja e mirëbërjes në bashkëpunim); "Ue tuksituu ilejhim" (Që të mbani drejtësi ndaj tyre); El-kistu: (maja e drejtësisë); këto dy fjalë konfirmojnë kuptimin që lindi nga përvoja e përgjithshme në realitetin e myslimanëve; ato nuk përfaqësojnë përjashtimet dhe parregullsitë nga situata e përgjithshme, por janë veçse një konfirmim për origjinën e saj".

C) BAZAMENTI EKONOMIK

Shumica e njerëzve të paanshëm e të drejtë prej historianëve të Civilizimit Islam mendojnë se në qoftë se ky civilizim nuk do të kishte ngritur, në mënyrë të mahnitshme, asgjë tjetër përveç sistemit të "vakëfit", si një sistem që përmbush një objektiv të dyfishtë që shfaqet në sigurinë ekonomike me rreze të gjatë (afatgjatë) për sektorë të veçantë të shoqërisë nëpërmjet të ardhurave prej vakëfeve nga një drejtim dhe garancisë së minimumit të pavarësisë së shoqërisë, nëse umeti islam, duke u nisur nga bazat e kulturës së tij, nuk do të kishte bërë mirë asgjë tjetër përveç këtij sistemi, kjo do të kishte qenë e mjaftueshme për të folur rreth bazamentit të fortë ekonomik në ngritjen islame. Megjithatë sistemi i vakëfit nuk është i vetmi në këtë kapitull. Në Sheriatin Islam gjenden detyrime dhe dispozita adhurimi (domethënë, ato janë të lidhura ngushtë me bazën e fetarisë të myslimanët). Ato detyrime nuk do të plotësoheshin veçse nëpërmjet shpenzimit material; domethënë nëpërmjet kontributit ekonomik për të forcuar themelet e strukturës shoqërore. Që këtu vjen rëndësia e dhënies së Zekatit, i cili përshkruhet si një kolonë bazë e Islamit, si një detyrë adhurimi me dimensione ekonomike e sociale dhe si shlyerje (e mëkateve) nëpërmjet dhënies ushqim të tjerëve, ose dhënies së lirisë skllervëve në rastet e agjërimit, të imanit, të dhiharit, etj.

Bazamenti ekonomik në ngritjen e umetit islam është i lidhur ngushtë me natyrën e këtij umeti nga aspekti i zbatimit të këtij rregulli fetar, i cili e lidh shpenzimin me shpërblimin në botën tjetër, madje edhe sikur të ishte thjesht me kryerjen e detyrës dhe thjesht duke iu përshtatur sistemit të tij në rregullat financiare prej një prireje të dukshme sociale. Shoqëria islame, në mënyrë të domosdoshme, është sferë shpenzimi e dhënieje. Individit mysliman dhe ai jomysliman prej atyre që jetojnë në shoqërinë e myslimanëve, janë pikërisht ata që do t'i këpusin në fund frytet e këtyre primeve shoqërore të cilat orientojnë veprimin financiar dhe rrugën ekonomike në Islam.

2. KARAKTERISTIKAT E UMETIT ISLAM

Baza shkencore e nocionit të umetit islam bën të domosdoshëm prekjen e karakteristikave dalluese të umetit, të cilat mund të përmbliken nëpërmjet bazamentit kulturor në lidhje me akiden dhe me vlerat e saj, ndoshta duke numëruar disa veçori, që i përshtaten zhvillimit të përvojës historike të umetit të ngritur mbi këtë akide dhe mbi ato vlera; megjithatë më të rëndësishmet e këtyre karakteristikave janë këto:

a) Ai është umeti i teuhidit (njësimit) të pastër të Allahut si Zot (El' Uluuhijjetu); i teuhidit (Er Rubuubijjetu), i cili i zhvesh njerëzit prej veçorive të të qenët perëndi; dhe i teuhidit të Emrave dhe Atributeve (Teuhiidul Esma' ues-Sifat) i cili i jep rastin njeriut të aspirojë e të shikojë horizontet e bukurisë në moralet dhe në cilësitë, si dhe të kërkojë më shumë prej atyre të dyjave, pa tejkaluar natyrën e tij njerëzore e cila është krejtësisht e paaftë dhe e mangët prej përgjegjësisë së të qenët e përshkruar me cilësitë e madhështisë. Ky teuhid i pastër nuk do të mund të depërtonte tek ai veçse nëpërmjet vazhdimësisë së leximit në Librin e shkruar të Allahut (El-Uahju, Shpallja) dhe në Librin e hapur të shtrirë (kozmosi).

b) Ai është umeti i diturisë: Argument për këtë është se ajeti i parë i Kur'anit që iu shpall Profeti Muhamed a.s. nuk ishte: "Puno", as "Lufto", dhe madje as "bëj sexhde" dhe as "adhuro", por ishte Fjala e Allahut: "Lexo! Me Emrin e Zotit tënd, i Cili ka krijuar..." (Kur'an, 96:1). Atëherë leximi është fillimi i shpalljes dhe hyrja për te perceptimi i vlerave të umetit dhe të nocionit të tij, mjeti nëpërmjet të cilit ripërtërihen kuptimet e fesë të vetë njeriu si dhe lidhja e tij me të (me leximin e Kur'anit). Meqenëse është i tillë, Kur'ani e shprehu në mënyrë të përmbledhur mesazhin e Profetit Muhamed a.s. në Fjalën e Tij xh.sh.: "Ai është i Cili çoi mes analfabetëve një të Dërguar (Muhamedin a.s.) nga vetë mesi i tyre, duke u kënduar atyre ajetet e Tij, duke i pastruar ata dhe duke u mësuar atyre Librin dhe urtësinë. Dhe vërtet që më parë qenë në gabim e humbje të qartë" (Kur'an, 62:2).

c) Ai është umeti ruajtës i trashëgimisë së Profetësive: Duke u nisur nga kuptimi kur'anor i cili aludon për Kur'anin si përforcues dhe vërtetues i burimit të Vahjit

[Shpalljes] në mesazhet e mëparshme "Dhe gjithçka që Ne ta kemi shpallur nga Libri [Kur'ani] është tamam e vërteta duke pohuar e vërtetuar çfarë që shpallur para tij. Vërtet që Allahu është padyshim Gjithënjohës dhe Gjithëshikues i robëve të Vet. Pastaj Ne u dhamë për trashëgimi Librin [Kur'anin] të atillëve nga robët Tanë të cilët Ne i zgjodhëm. Pastaj prej tyre janë disa që gabojnë vetveten e tyre, dhe po prej tyre janë disa të cilët ndjekin një rrugë të mesme, dhe po prej tyre disa janë më të parët në mirësi me Vullnetin e Allahut. Ai [trashëgimi i Kur'anit], mu ai është, në të vërtetë, përkujtim e mirësi e madhe" (Kur'an, 35: 31-32).

d) Ai është umeti i dialogut: Natyra e referimit origjinal, e cila i orienton umetit një natyrë dialoguese, është se Kur'ani Fisnik, në njërin prej aspekteve të tij, në mënyrë të dallueshme, është Libër i rrugës së dialogut, jo thjesht pse ai i solli diskutimet dhe debatet e profetëve me popujt e tyre si elementë të nxjerrjes së mësimave dhe për të reflektuar, por sepse ai e përfshiu përmendjen e fjalës së kundërt, atë fjalë për të cilën logjika kur'anore e gjykon si fjalë të pa themel dhe kontradiktore, dhe kjo duke mos qenë penguese për ta sjellë atë në gjuhën e njerëzve të saj para përgjigjes me argumentin e qartë dhe me provën elokuente. Në Kur'anin Fisnik ndodhen shembuj të shumtë të këtij adresimi: "Do të thonë mendjelehtët...", "Dhe ata që mohuan thanë...", "Kur erdhën tek ti hipokritët thanë...". Pastaj, parimi i konfirmimit dhe i deklarimit për këdo që ka vërtetësi dhe që duke qenë ai që e shprehu atë, është njëra prej veçorive të adresimit kur'anor. Duke u mbështetur mbi këtë, umeti islam është i ftuar për të bashkëbiseduar me të tjerët me atë mënyrë që është mbi metodën e mirë (me atë që është më e mira): "Ftoji në Udhën e Zotit tënd me urtësi dhe me thirrje të ndershme dhe të bukur dhe bisedo me ta në mënyrën më të mirë" (Kur'an, 16:125).

Nuk ka dyshim se ato karakteristika dhe ato bazamente i siguruan dhe i garantuan umetit një potencial të mahnitshëm për qëndrueshmëri e vazhdimësi gjatë periudhave të historisë, pavarësisht dëshirave për ta asgjësuar e shfarosur, me të cilat ky umet u përball, dhe pavarësisht sulmeve shkatërrimtare dhe gjenocidit, që rrallëherë ka njohur historia si shembulli i tyre, dhe ato nuk janë të fundit; gjithashtu edhe sulmi i gjithanshëm kolonizator në të gjithë faktorët, jetikë qofshin materiale apo shpirtërore. Që këtu, duket qartë rëndësia vendimtare e atyre bazave dhe karakteristikave lidhur me umetin islam sot ndaj sfidave të mëdha me të cilat akoma po përballët, madje të cilat sot kanë marrë një trend në rritje, dhe nuk mund të sigurohet sukses ndaj sfidave veçse nëpërmjet përtëritjes së prodhimit të vlerave, të cilat garantuan për këtë umet qëndrueshmërinë e vazhdimësinë në të shkuarën, në të tashmen dhe ato janë garanci për përjetësinë e tij në të ardhmen".

**(Qendra e studimeve dhe e kërkimeve
njerëzore dhe sociale - Uexhdeh, Marok)
Shqipëroi nga arabishtja: Jusuf Salkurti**

YMETI IM ËSHTË SIKURSE SHIU I FRYTSHËM, NUK DIHET A ËSHTË MË I MIRË FILLIMI APO FUNDI I TIJ

Allahu i Madhërishëm në Kur'an shpalli:

"Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre." (Err - Ra'd, 11)

Ky është ajeti të cilin myslimanët e dëgjojnë për çdo ditë nga minberët e xhamive tona si dhe në raste të tjera, dhe ky shtron rregullin kur'anor në të cilin ofrohet zgjidhja dhe dalja nga të gjitha krizat dhe provat.

Mesazhi i parë i kësaj të vërtete kur'anore është se gjendja e bollëkut, mirëqenies, lumturisë dhe suksesit nuk mund të ndryshojë, derisa ata që jetojnë në këtë mirëqenie nuk ndryshojnë, përderisa vetë nuk i propozojnë themelet e jetës së lumtur dhe të mirë. Por, po ashtu nëse gjendja jonë është negative, nëse kalojmë nëpër kriza të ndryshme, vuajtje, prova dhe intriga, Allahu edhe këtë gjendje nuk do ta ndryshojë derisa ne nuk ndryshohemi, derisa nuk ndërmarrim hapat që nënkuptojnë zgjimin nga gjumi, i cili kupton gatishmërinë për sakrificë në emër të idealeve të larta, gatishmërinë e luftës për liri, drejtësi, të vërtetën, dhe gatishmërinë që të bëhemi

të durueshëm deri te qëllimet e larta dhe që asnjëherë të mos humbim shpresën në mëshirën e Allahut dhe fitore.

Mesazhi i dytë i këtij ajeti është që ndryshimi për të cilin flet Kur'ani vjen nga brenda, e kurrësi nga jashtë. E kjo d.m.th. që krizat politike, ekonomike, morale, etj., nëpër të cilat ne po kalojmë si ymet, pastaj armiqësia, krimet, okupimi i vendeve myslimane, vrasjet masive të fëmijëve, grave dhe pleqve, shfrytëzimi i të mirave të myslimanëve, intrigat e armiqve sikurse nyjet e shejtanit që vijnë njëra pas tjetrës e të cilave nuk u shihet fundi, nuk do të zhduken përderisa myslimanët nuk ndryshojnë nga brenda, përderisa nuk e ndryshojnë marrëdhënien e tyre me Allahut, me njëri-tjetrin dhe me jetën në përgjithësi.

Mesazhi i tretë, që transmeton ky ajeti, është fakti se njeriu vërtet është i aftë që të bëjë ndryshime, që të ndryshojë gjendjen e jetës së tij, ngase sikur njeriu të mos e kishte këtë mundësi, atëherë as dërgimi i peygamberëve të Allahut nuk do të kishte kuptim dhe në këtë rast çdo formë e veprimit njerëzor dhe përpjekje

do të ishte e kotë. Nëse njeriu nuk është i aftë të ndryshojë ambientin ku jeton, atëherë përse mëson, studion dhe hulumton?! Vetëm për arsye se njeriu është vërtet i aftësuar të bëjë ndryshime dhe të ndikojë në rrjedhat e jetës, Allahu dërgoi pejgamberë dhe shpalli libra.

Mesazhi i katërt është që mundësia e ndryshimit është pjesë e besimit dhe bindjes personale. Ne nuk mundemi të ndryshojmë asgjë nëse nuk jemi të bindur që kemi mundësi për këtë dhe nëse nuk kemi dëshirë që të ndryshojmë gjërat për të mirë.

E pamundur është vetëm ajo që nuk dëshirojmë ta bëjmë.

Problemi i myslimanëve të sotëm është pikërisht ajo që jeta jonë është e shënuar me inerci, pasivitet, oportunizëm dhe fatalizëm. Edhe pse fatalizmi është i huaj në Islam, për shumicën e myslimanëve sot, për shkak të moskuptimit të Kur'anit dhe syneit, është karakteristikë e lënies dhe dorëzimit të fatit, shikimit pesimist të realitetit, dorëzimit pa luftë, pritjes që fitorja dhe suksesi të vijë nga qielli, nga vetvetja, ndërsa nuk kemi ndërmarrë asgjë hap deri te kjo dhe kurrësi nuk interesohemi për ndryshim, por vetëm dëshirojmë fuqishëm që të zgjidhim problemet dhe të bëhet më mirë, ndërsa këto janë vetëm dëshira boshe dhe fantazi.

Një njeri i ka thënë Ibn Sirinit: "Kam ëndërruar duke notuar në pishinë pa ujë dhe duke fluturuar pa krahë. Çfarë do të thotë kjo? Ibn Sirini iu përgjigj: 'Ti je njeri i cili fantazon shumë.'"

Fantazia dhe shpresa nuk janë dy gjëra të njëjta. Ai i cili vetëm fantazon, ai vetëm i dëshiron të gjitha të mirat e kësaj bote pa punë dhe pa përpjekje. Ndërsa për ata që nuk fantazojnë, por shpresojnë në bazë të veprave reale, Allahu thotë:

"Kush shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurim ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askënd." (El - Kehf, 110)

Transmetohet që Shekik Belhi kërkoi nga shejhu i tij, Ibrahim Edhemi, që ta lejojë të udhëtojë për tregti, dhe shejhu e lejoi. Në rrugën e tij tregtare, Shekik Belhi pa një zog të verbër dhe me krahë të thyer. U ul dhe filloi të mendojë:

- "A thua si ushqehet ky zog, si jeton kështu në këtë vend?" Nuk kaloi shumë kohë dhe fluturimthi erdhi një zog tjetër dhe i solli ushqim. Shekiku u çudit nga kjo skenë dhe i tha vetes:

- "Kur Allahu kujdeset për furnizimin e këtij zogu në shkretëtirë, përse të lodhem e të merrem me tregti në këtë moshë?" Dhe u kthye

në shtëpi. Kur e vizitoi shejhun, ai e pyeti përse u kthye, ndërsa Shekiku ia rrëfeu tregimin për zogun e verbër me krahë të thyer dhe tjetrin që e ushqeu, dhe vendimin e tij për t'u kthyer, ngase ja, Allahu i jep furnizim atij zogu, dhe do t'i japë edhe atij. Ibrahim Edhemi i tha: "I mjeri ti, o Shekik! Përse nuk zgjodhe të jesh zog u shëndoshë, i cili përpiket dhe lodhet e pastaj i sjell familjes së tij dhe u shërben atyre përreth, por zgjodhe të jesh zog u verbër të cilin duhet ta ushqejnë të tjerët?! A thua nuk ke dëgjuar se Pejgamberi a.s. ka thënë: 'Dora e lartë është e mirë se e poshtmjë.'"

Omeri, r.a., thoshte: "Askush nga ju mos të ulet duke pritur rrëskun e duke u lutur 'O Allahu im, më furnizo!' Ju e dini mirë se nga qielli nuk bie floriri dhe argjendi."

Problemi qëndron se shumë myslimanë sot presin ditën kur do të zgjohen duke parë sesi Allahu i ka dënuar dhe mposhtur armiqtë e Islamit dhe myslimanët do të fillojnë jetën e tyre në qetësi, rehati, paqe, liri e prosperitet të përgjithshëm.

Problemi është po ashtu që nga brenda jemi të mposhtur dhe e dekurajojmë dhe e nënçmojmë veten, dhe që justifikohemi me pretendimet si: populli është i prishur, mediat të prishura, shoqëria është në greminë dhe shkatërrim, nuk ka shpëtim për ne, ngase ne jemi gjenerata më e keqe e ymetit islam.


Ata të cilët mendojnë kështu për gjeneratën aktuale të myslimanëve, para se gjithash duhet të dinë se kjo nuk është e vërtetë dhe në gjeneratat e myslimanëve të sotëm ka shumë të mira, e pastaj kjo është në kundërshtim me thënien e Pejgamberit a.s.:

"Ymeti im është sikurse shiu i frytshëm, nuk dihet a është më i mirë fillimi apo fundi i tij." (Tirmidhiu)

Dijetarët kanë thënë: "Njeriu nuk do të ndryshojë nëse nuk ka dëshirë të ndryshohet qoftë edhe nëse lexon me mijëra libra dhe arrin titujt më të lartë shkencorë."

Vendimi dhe dëshira që të ndryshohet gjendja jonë dhe besimi që kjo mund të ndodhë, janë supozime kyç për reforma dhe ndryshime. Kur besimtari kupton se me ndihmën e Allahut nuk ekzistojnë gjëra të pamundura, nuk ekzistojnë situata të pamundura, atëherë ndryshimi do të vijë, sepse e pamundur është vetëm ajo që nuk dëshirojmë dhe nuk duam ta bëjmë.

**Burimi: www.saff.ba
Përktheu dhe përshtati:
Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi**



H. HAFIZ DR. HASAN KADUKU **(1865-1948)**

**NJË HAFIZ KUR'ANI, MJEKU I PARË
STOMATOLOG SHQIPTAR**

Hasan Kaduku lindi në Shkodër dhe ishte djali i madh nga pesë djemtë e Ismail (Mala) Kadukut, një tregtar i njohur në pazarin e qytetit në punimin e lëkurave, burrë i ndershëm, dijedashës dhe atdhetar. Hasani ishte vëllai i madh i Haxhi Ibrahim Kadukut, i cili kreu detyra të rëndësishme në shërbim të Islamit dhe vendit të tij, vëllai i Riza Kadukut, funksionar në Komunitetin Mysliman në sektorin e financës, Sulejmanit (i cili posedonte kartolerinë më moderne), si dhe Hafiz Jusuf Kadukut, një prijës fetar i shkolluar si vëllezërit e tij Hasan e Ibrahim në Universitetin e Stambollit, ku njihej për komentimin e Kur'anit gjatë qëndrimit atje.

Hasan efendi që në moshë të re shkon në Stamboll për të vazhduar shkollën, ku vendoset pranë dajës së tij, Fetah Lini, ku fillon edhe punë. Atje njihet me dijetarë të kohës, nga të cilët merrte edhe mësim mistik, si dhe filloi mësimin përmendësh të Kur'anit. Sipas kronikanit Hamdi Bushati, mësuesit e tij kishin vënë re se kishte disa probleme me dhëmbët e parë të cilët i kishin rënë dhe bënin që të mos i shqiptonte qartë shkronjat arabe me "texhvid", të cilët duan një vokalizet shumë të pastër. Nga dashuria që kishte për Kur'anin, ai vendos fillimisht që, paralel me mësimin e Kur'anit, të rregullojë edhe dhëmbët, ku u njoh edhe me profesionin e dentistit, të cilin e dashuroi menjëherë. Kështu ai i lutet dentistit të tij, që ta merrte në punë, por dentisti i thotë se nuk ka nevojë. Hafiz Hasani i thotë se, "ti nuk ke nevojë për mua, por unë kam nevojë për ty dhe jam gati të të paguaj rrogë, vetëm të rri pranë teje dhe të mësoj profesionin", e kështu ndodhi. Më vonë fillon praktikën edhe pranë dentistit të famshëm Halid Shenazi Bej dhe më pas dhe te profesor Dionizi me kombësi armene. Pasi siguron lejen e ushtrimit të profesionit, ai kthehet në vendlindjen e tij, në Shkodër.

Kështu ai për një kohë të shkurtër, rreth tre vjeçare, bëhet Hafiz Kur'ani dhe dentist.

Hafiz Hasani me t'u kthyer nga Stambolli në Shkodër, fillon ushtrimin e këtij zanati, duke hapur një klinikë portative, duke shkuar në shtëpitë e atyre që kishin nevojë, siç shkonin edhe mjekët e tjerë. Por, nga dëshira e madhe për profesionalizëm të plotë me t'u hapur Fakulteti i Stomatologjisë në Universitetin e Stambollit (1907), pasi punoi disa vjet si dentist diletant, në një moshë kur tashmë ishte familjar dhe me fëmijë, shkon përsëri në Stamboll, ku nga tre vjet studimi, që kishte fakulteti, ai i kryen studimet për dy vjet, favor ky që i bëhej atyre që kishin njohuri praktike disa vjeçare. Hafiz Hasani arrin të bëhet një nga studentët më të përparuar të fakultetit, pavarësisht moshës së tij gati 40 vjeçare. Madje familjarët e tij tregojnë se edhe letrat që i vinin nga familja nuk i hapte deri në fundjavë, për të mos u shpëputur nga mësimet. Ai diplomohet më 1908 dhe kthehet në vendlindje si i pari mjek stomatolog, apo siç njihej ndryshe "mjek dhëmbësh" me diplomë universiteti, jo vetëm në Shkodër, por në të gjithë Shqipërinë. Ai njihte gjithashtu shumë mirë gjuhën arabe, osmane dhe frënge.

Hafiz Hasan Kaduku mbahet si njeriu që vuri bazat e shërbimit stomatologjik modern në qytetin e tij të lindjes, në Shkodër.

Kronikani Hamdi Bushati tregon se Hafiz Hasan Kaduku e ushtroi profesionin si dentist në disa qytete të Shqipërisë dhe në Mal të Zi. Kronikat e asaj kohe tregojnë se Hasan Kaduku, me zotësinë e një dentisti të talentuar, tërhoqi vëmendjen e të gjithë bashkëqytetarëve të tij, duke krijuar një klientelë të gjerë edhe jashtë kufijve të vendit, si p.sh. në Mal të Zi. Të gjithë konsujt e huajt që ishin të akredituar në Shkodër, si dhe personalitete të viseve të tjera të vendit, kishin si dentist (apo siç quhej atëherë mjek dhëmbësh) të tyre Hafiz Hasan Kadukun. Shkodra në fillim të shekullit XX, duke qenë një



Foto XVI - QUTER 1906 - Nr. 121

Faksimile e njëfarit të botuar tek gazeta "Elçija e Zëmres së Krishtit, 1906.



Dr. Haki Hasan Kaduku, dentist, në laboratorin e tij / Dr. Haki Hasan Kaduku, dentist, në laboratorin e tij, Shkoder, 1931

prej pikave më perëndimore të Perandorisë Osmane, kishte pesë konsullata të huaja, personeli i të cilave bëheshin shpeshherë pacientë të Hafiz Hasanit.

Hafiz dr. Hasan Kaduku ua la trashëgim profesionin e tij pinjollëve të tjerë të familjes, e cila në atë kohë ishte një ndër më të njohurat në Shkodër. Haki Kaduku, djali i dentistit të parë shqiptar, pasi kreu gjimnazin në Austri dhe fakultetin e stomatologjisë në Stamboll, u kthye në Shkodër. Ai vijoi profesionin e të atit, duke punuar kështu bashkë. Derisa doli në pension, Hakiu, djali i Hasan Kadukut, punoi si dentist në poliklinikën e qytetit të Shkodrës. Ai ishte një mjek i cili i kushtonte një rëndësi të madhe edukimit të rinisë për përkujdesjen shëndetësore. Haki Kaduku mbante biseda për përkujdesjen ndaj dhëmbëve në shkollat e shtetit të të gjitha niveleve.

Tradita e familjes Kaduku vazhdon me të tjerë emra. Qamurani, djali i Hakiut dhe nipi i Hafiz Hasanit, është brezi i tretë i dhëmbëtarëve të kësaj familjeje. Ndërsa Hasan Haki Kaduku, nipi i Hafiz Hasanit ka ushtruar profesionin e profesorit të matematikës në shkollat e qytetit. Ndërsa Mesereti, njëra nga vajzat e Haki Kadukut, ashtu si vëllai i vet arsimtare në matematikë, do të vinte bazat e matematikës për shumë vite në Medresenë "Haxhi Sheh Shamia" në Shkodër.

Studiuesi Osman Hoxha e përshkruan kështu figurën e Hasan Kadukut: "Njeri madhështor, shtatlartë e shpatullgjerë, syshqiponjë e hundëshkabë, me mjekër të bardhë dhe shumë i pashëm, fisnik dhe zemërgjerë, i

respektuar dhe mendjemprehtë, energjik dhe i papërkulur, i dashur e bujar, ishte gjithmonë mes njerëzve, që e donin dhe i donte aq shumë. Ishte i punës por dhe i pushkës. Në kohën e rrethimit të Shkodrës nga malazezët në vitet 1912-1913, Hafiz Hasan Kadukun e gjejmë të rreshtuar në llogore përkrah vullnetarëve të tjerë, duke kryer detyrën ndaj atdheut.

Në vitin 1932 kreu edhe ritualin e Haxhit. E tashmë njerëzit e njihnin si Dr. Haxhi Hafiz Hasan ef. Kaduku."

Shprehja "po shkoj te Kaduku", më shumë se prej një shekulli në Shkodër nënkupton "po shkoj te dentisti".

Klinika e famshme dentare "Kaduku", në vitin 1948 do të sekuestrohej e gjitha nga shteti, duke bërë kështu që shumë klinika shtetërore për stomatologji në Shkodër dhe Tiranë, të hapeshin me veglat e shtetëzuara të dr. Kadukut.

Klinika e Hafiz Hasanit ndodhej në pikëtakimin e lagjeve të vjetra myslimane dhe katolike, e cila shërbeu kështu edhe si një busull afrimi mes dy besimeve, sepse pacientët ishin nga të dyja lagjet.

Shenjë e tolerancës është edhe një fakt interesant ku revista katolike e kohës "Elçija e Zembrës s'Krishtit", e vitit 1906 (vjeta XVI, Dhetuer, 1906, nr. 12), boton një reklamë interesante të Hafiz Hasan Kadukut, i cili i fton klientët që të mbushin apo të venë proteza dhëmbësh në klinikën e tij dhe paratë mund t'i paguajnë më vonë, pasi ata të jenë mësuar me protezat apo mbushjet dhe të jenë të kënaqur prej tyre.

Hafiz Hasan Kaduku ishte intelektual i plotësuar për kohën, ndaj dhe gëzonte respektin e

banorëve të qytetit. Ai vishej me shije dhe ishte i dashur si me pacientët, ashtu dhe me shoqërinë që e kishte të shumtë. Paradhoma ku prisnin pacientët ishte e akomoduar mirë dhe e pajisur me libra dhe revista, madje aty kishte edhe libra për fëmijë apo ndonjë lodër.

Kultura e tij e gjerë bënte që ai të vizitohej edhe nga klerikë të lartë katolikë, si Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Anton Harapi, etj.

Madje Fishta i kishte kushtuar Hafiz Hasan Kadukut edhe këto vargje, të cilat tregojnë se ai ishte mjekuar te mjeku i shquar stomatolog:

"Asnjëherë s'jam përkulë

As prej shkajut e as dhe ukut

Por rri urtë e bahem pulë

Te karrigia e Kadukut"

I biri i tij, dr. Haki Kaduku, tregon se dr. Hasani ishte i pari që përdori floririn në mbushjen e dhëmbëve. Ai përdorte një peshore precize të farmacistëve, për të racionuar sasinë e arit për punimet e veçanta.

Kur mosha bëri të veten, Hafiz Hasani vetë kaloi në laborator dhe Hakiu në klinikë. Ai ishte i pari që mbajti korrespondencë me një firmë londineze (A. SH. & Sons), nga ku ka porositur edhe klinikën e tij, të cilën e ka pasur me qira në shtëpi të ndryshme shkodrane, njëra prej të cilave është fotografuar edhe nga Marubi.

Studiuesi i njohur, profesor Gëzim Uruçi, në dosjen e tij "Personalitete të shquara në memorien e malësorëve tanë", (Haxhi Dr. efendi Kaduku dhe kroni i Kadukut në fshatin Theth të Dukagjinit), na njeh me shumë histori, episode dhe toponime që hapin një faqe të re shumë interesante për figurën e Hasan Kadukut. Lidhur me këtë ka shkruar edhe dr. Musa Bizaku,

duke bërë një monografi për brezninë Kaduku.

Hafiz Hasani ishte ndër të parët pushues dhe i pari mysliman që veroi në fshatin turistik të Thethit që nga viti 1936, i ftuar fillimisht nga bajraktari i zonës, i cili ishte edhe pacient i tij.

Dr. Hasani i mahnitur nga bukuritë dhe ujërat e Thethit, mendon t'i bëjë një shërbim humanitar Thethit, një nxitje për emancipim, duke bërë një marrëveshje të firmosur nga vetë ai dhe lënë shenjat e gishtërinjve nga bajraktari i Shoshit. Ai ndërtoi depozitën e parë të ujit, duke hapur kanale në drejtim të tre kullave kryesore aty pranë. Për këtë arsye, të futjes së ujit në disa shtëpi për herë të parë, që nga ajo ditë ai krua quhet "Kroni i Kadukut". Kështu krahas kësaj hynë edhe toponime të reja "Livadhi i Kadukut", "Bajrakja e Kadukut", etj. Ai i ftoi gjithashtu thethianët që të vinin dhe t'i kuronin dhëmbët falas në klinikën e tij në Shkodër. Gjatë qëndrimit në bjeshkët e Thethit ai mblidhte dhe përpunonte shumë bimë mjekësore, duke njohur vlerat e tyre për kurimin e shumë sëmundjeve evidente në këtë zonë.

Dr. Hasani, sipas dëshmisë së Lulash Markut, fshatar i zonës, ishte bërë shumë i vizituar nga malësorët e zonës, madje ai me kënaqësi u lexonte edhe letrat që u vinin atyre.

Hafiz Dr. Hasan Kaduku kuroi e mjekoi gjatë jetës së tij krajla, princa, konsuj, priftërinj, diplomatë e njerëz të thjeshtë. Në karrigen e tij u ulën gjithashtu njerëz të shumë kombësive.

Dr. Frederik Shiroka do ta quante Haxhi Hafiz Dr. Hasan Efendi Kadukun "Legjendë e stomatologjisë shqiptare".

30 VJET NGA RIHAPJA E XHAMISË

“Ethem Beu”



Rihapja e xhamisë "Ethem Beu" në Tiranë, më 18 janar të vitit 1991, u bë me një ceremoni madhështore, në të cilën morën pjesë mijëra besimtarë dhe qytetarë të Tiranës. Ajo ishte dita kur emocionet, entuziazmi shpirtëror dhe shpërthimi i ndjenjave për qytetarët e Tiranës, kishin arritur kulmin. Njerëzit të përmalluar, dëgjonin me vëmendje e kureshtje, qanin e çmалleshin me xhaminë. Xhamia "Ethem Beu" i kishte mbyllur dyert e saj 23 vite më parë, për shkak të ndalimit të besimit në Shqipëri nga sistemi komunist, i cili u shoqërua me masa të rrepta, me persekutime, burgosje e vrasje të prijësve fetarë që kishin predikuar fenë.

Me 13.11.1967, Presidiumi i Kuvendit Popullor, me dekret nr. 4337, shfuqizoi të gjitha ligjet e dekretet e mëparshme mbi komunitetet fetare dhe statutet e tyre. Dhe kështu, Shqipëria u shpall shteti i parë ateist në botë, i cili kulmoi me aksionin e madh për rrënimin e xhamive, duke i sjellë vendit një dëm të dyfishtë edhe për vlerat e pazëvendësueshme kulturore, historike e arkeologjike të tyre.

Me rënien e sistemit komunist më 1990, u rivendos liria e fesë. Institucioni i Komunitetit Mysliman i

sapongritur, filloi angazhimin e punës për hapjen e xhamive anembanë vendit. Drita e Islamit filloi të përhapej në vendin tonë, lulëzuan xhamitë si vende lutje e adhurimi dhe në minare buçiste zëri i ëmbël që madhëronte Zotin xh.sh. Më 16.11.1990, ishin qytetarët e Shkodrës, myslimanë e katolikë që morën pjesë në rihapjen e xhamisë së Plumbit në një tubim masiv. Këto rihapje u pasuan më 14.12.1990 me xhaminë Mbret - Berat, më 11.01.1991 me xhaminë e Plumbit - Vlorë...

Shumë prej xhamive të Tiranës qenë shndërruar ose rrënuar dhe trualli i tyre ishte zëvendësuar me ngrehina të tjera, por, për fatin e mirë, xhamia "Ethem Beu", e cila bashkë me kullën e sahatit ishin bërë simbol i kryeqytetit në çdo imazh fotografie apo pikturë që përfaqësonte Tiranën, arriti t'i shpëtonte tiranisë së komunizmit, që u përpoq të shkatërronte çdo vlerë të besimit. Ishte prej begatave të Zotit, që kjo xhami qëndroi më këmbë gjersa u rihap sërish për t'iu rikthyer zemrave të besimtarëve.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë kujton se ishin Xhavit e Iljaz Alimehmeti, Ramazan Rusheku, Ibrahim Balla, Mehmet Sinella, etj.,

disa nga nismëtarët kryesorë myslimanë, të cilët hapën në Tiranë dyert e xhamisë "Ethem Beu" për besimtarët. Përmbajtja e fjalimeve të tyre në xhami, mund të përmbledhet në thirrjen e njerëzimit për paqe, dashuri, harmoni, mirëkuptim, bashkëpunim, miqësi e vëllazërim midis njerëzve pa dallim.

Atë të premtë janari, për qytetarët e Tiranës kishte zbardhur një ditë e madhe, e cila do t'i ringjallte shpresën për ditë më të mira. Në fytyrat e pjesëmarrësve lexohej gëzimi për këtë ngjarje të madhe, e cila shënonte rikthimin e besimit në jetën e tyre, pas një diktature të shfrenuar dhe një regjimi të ashpër komunist, i cili u përpoq të ç'rrenjosë fenë dhe besimin, por që kurrë nuk ia doli mbanë. Edhe pse 23 vjet ngricë shpirtërore, shumë qytetarë të Tiranës, kishin ruajtur brenda tyre dashurinë për Zotin, kishin ruajtur ndezur brenda shpirtit të tyre një zjarr, që nuk lejoi ngricën komuniste të ftohte besimin e tyre në Zot. Kjo gjë, u vërtetua pikërisht në këtë ditë.

Vlerësim dhe mirënjohje për të gjithë ata njerëz, që me zell e përkushtim kontribuan në skalitjen e datës 18 Janar 1991 në kujtesën historike të Tiranës, si dita e rihapjes së xhamisë "Ethem Beu".



Të edukosh me dhembshuri

Është një kënaqësi e veçantë të jesh pjesë e një aktiviteti të tillë mbresëlënës. Në radhë të parë dua të falënderoj organizatorët për ftesën që më bënë. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për të gjithë ata që kanë kontribuar në hapjen e gazetës së parë islame, të cilët me qëllimin e pastër e të sinqertë dhe me punën e palodhur arritën të takojnë lexuesit me dritën e vërtetë të Islamit. Pas 29 viteve, gazeta 'Drita Islame' tashmë është shndërruar në një revistë bashkëkohore, ku krahas informacionit fetar mund të gjejmë artikuj të fushave të ndryshme, si nga letërsia, filozofia, sociologjia, aktivitetet socio-kulturore, etj. Kjo revistë e larmishme është një dritare e hapur ku lexuesi merr mesazhet e paqes, tolerancës, dashurisë e besimit. Rugëtimi i saj i gjatë dhe i suksesshëm është shenjë treguese e punës së përkushtuar të stafit dhe dëshirës së madhe të lexuesit për ta pasur pranë.

Në artikujt e botuar nga ana ime jam fokusuar te rëndësia e familjes, edukimi i fëmijëve, roli i prindërve në edukimin e fëmijëve, çelësi i një familjeje të lumtur. Familja konsiderohet guri themelor i një shoqërie pa të cilën ajo nuk do të ekzistonte. Formimi i një familjeje të konsoliduar sigurisht që kërkon ndërgjegjësim, sakrificë, respekt, bashkëpunim dhe, ç'është më e rëndësishmja, dashuri. Marrëdhënia mes dy prindërve përcakton dhe ndikon ndjeshëm në ritmin e edukimit dhe ecurinë e zhvillimit të karakterit të fëmijës. Një marrëdhënie e shëndoshë mes bashkëshortëve përkthehet me fëmijë të sigurt në vetvete, të suksesshëm në shkollë dhe të mirë-edukuar. Edukimi i fëmijëve përbën një përgjegjësi të rëndë mbi supet tona, nëse i konsiderojmë ata si një amanet i vyer i Krijuesit fisnik.

Të mos harrojmë fjalët e vyera të Profetit tonë të

dashur teksa thotë: "Nuk ka gjë më të mirë që një prind mund t'i japë fëmijës sesa një edukatë e mirë." Ato janë fëmijët tanë por në të njëjtën kohë janë individë unikë, të ndryshëm nga ne me personalitetin dhe dëshirat e tyre. Edukimi i fëmijës fillon që në barkun e nënës dhe vazhdon më pas në fëmijërinë e hershme e deri në adoleshencë. Secila etapë ka karakteristikat dhe problematikat përkatëse të cilat mund të kalohen me anë të ndjenjës së dhembshurisë. Të edukosh me dhembshuri nuk do të thotë të tregohesh i dobët përballë fëmijës tënd, përkundrazi do të thotë të jesh i duruar, tolerant në rastet e dhurës, falës kur ai gabon, shoku më i mirë i tij. Edukimi me dhembshuri bën të mundur dhe zhvillimin, maturimin emocional të fëmijës, e bën atë të ndjeshëm ndaj njerëzve e ngjarjeve përreth tij.

Emrat Rrahman (Gjithëmëshirshëm) dhe Rrahim (Mëshirues) të Allahut të madhëruar janë burim i çdo dhembshurie, delikatese e mëshire. Dhembshuria është një ndjenjë e lindur nga dashuria, ekzistuese te secili prej nesh që në lindje, diku më pak e diku më shumë, është një koncept i cili përfshin dashurinë, mëshirën dhe solidaritetin. Kriteri themelor i suksesit në edukimin e fëmijëve është dhembshuria. Ajo mësohet si një model apo shembull nga fëmija. Prindi, nëna dhe babai janë modelet e para të fëmijës, nga të cilët ai mëson, kopjon çdo gjë. Të mos harrojmë se fëmijët kopjojnë më shumë veprimet, sjelljen tonë dhe jo fjalët këshilluese që shpeshherë ua përsërisim. Shembulli më i mirë i dhembshurisë e mëshirës për ne padyshim që është Profeti ynë (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të).

"E Ne të dërguam Ty Muhammed vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat." (Enbija, 107) thekson i Lartmadhëruari në Kur'anin Fisnik. Qëllimi i ardhjes së tij ishte të zbuste

zemrat e njerëzve me ilaçin e dhembshurisë e mëshirës. Pse të mos e shfrytëzojmë edhe ne këtë ilaç?

Enes ibn Malik rrëfen: "I shërbeva të Dërguarit të Allahut dhjetë vjet por nuk më kujtohet që të më ketë thënë 'pse s'e bërë' për një gjë që s'e pata bërë dhe 'pse e bërë' për një gjë që e pata bërë. Ai kurrë nuk më qortoi." (Buhari, Edeb). Kjo ishte mënyra e sjelljes së Profetit tonë të dashur, shumë dhembshuri e aspak kritikë apo qortim. Nëse fëmija duhet të ketë frikë prej diçkaje ai duhet të ketë frikë jo nga kërcënimi, ndëshkimi, kritika apo bërtitjet, por nga humbja e dhembshurisë prindërore. Ndërkohë është shumë e rëndësishme që ai të besojë tek ne dhe të jetë i bindur se jemi pjesë e dhimbjeve të tij.

Secili prind duhet ta pranojë fëmijën e tij ashtu siç është dhe të tregohet tolerant me të. Shumica e njerëzve shpeshherë tregohen tolerantë ndaj njerëzve të huaj dhe jo shumë të afërm dhe harrojnë të tregojnë dhembshurinë e kërkuar përballë fëmijës apo bashkëshortes së tyre. Të pranosh gabimet e fëmijës si hedhja e sendeve, hapja e sirtarëve, kërkesa me këmbëngulje e diçkaje është një formë e shprehjes së dashurisë së vërtetë dhe pasqyrim i dhembshurisë brenda teje. Është një urë e cila shpie në korrigjimin e sjelljeve të padëshiruara. Mbi të gjitha është një tregues se dashuria jote për fëmijët është e pakushtëzuar me një sjellje të caktuar, sidomos para moshës dhjetë vjeçare, moshë e formimit, edukimit dhe orientimit. Dhembshuria është një shtyllë e fuqishme në edukimin pozitiv të fëmijëve dhe në orientimin e duhur të tyre.

Toleranca ndaj gabimeve të fëmijëve do të forcojë lidhjen tonë me fëmijën dhe do ta shtyjë atë të komunikojë në mënyrë të sqartë e pa frikë me ne. Nëse prindi do të kundërpërgjigjet me ndëshkim e ashpërsi ndaj gabimeve të fëmijës, madje edhe ndaj atyre gabimeve të parëndësishme, kjo do të ndikojë negativisht në personalitetin e fëmijës. Gabimi më i madh këtu është fokusimi te një sjellje e gabuar dhe përgjithësimi i saj me personalitetin e fëmijës, duke e shoqëruar edhe me etiketime ofenduese. Një edukues pozitiv i mbushur me dhembshuri duhet t'i konsiderojë gabimet e përditshme si gabime të vogla të cilave nuk u duhet kushtuar vëmendje. Ai fokusohet te puna serioze që duhet bërë për korrigjimin e sjelljes, të gjejë metodat dhe rrugën e duhur për këtë. Kjo mënyrë veprimi do t'i dhurojë prindit një qetësi të brendshme, do ta bëjë atë të ndihet mirë, ta mbushë me dashuri e dhembshuri dhe njëkohësisht do t'i mësojë durimin, vetëkontrollin dhe maturinë të cilat janë veçoritë thelbësore të një edukuesi pozitiv.

Një mënyrë e shprehjes së dhembshurisë suaj është edhe solidarizimi me fëmijët. Të solidarizohesh me fëmijët konsiderohet një formë edukimi tepër efikase, pasi ndihmon në fokusimin e shëndoshë në realizimin e objektivave dhe distancimin nga reagimet hakmarrëse.

Mosvlerësimi dhe injorimi i fëmijëve prodhon mungesë respekti dhe sjellje agresive. Fëmija ka nevojë të ndihet i vlerësuar dhe kjo është një nevojë emergjente të cilën mund t'ia plotësojmë. Vlerësimi i fëmijëve me fjalë dhe sjellje është një domosdoshmëri dhe këtë mund ta arrijmë pa shumë mund, por vetëm me shumë çiltërsi e sinjeritet. Mjafton një buzëqeshje, një lavdërim, një fjalë e mirë mirënjohëse, një shprehje pozitive, një përqafim.

Psikologia amerikane Virginia Satir thekson se një fëmije i duhen 12 përqafime në ditë për të mbijetuar emocionalisht, 4 janë për të mbijetuar dhe 8 të tjera për të mbajtur veten dhe për t'u dhuruar të tjerëve dashuri e ngrohtësi. Secili prej nesh mund të pyesë veten nëse e ka përqafuar sot fëmijën e tij kur është zgjuar nga gjumi apo para se ta përcjellë për në kopsht apo shkollë. Askujt nuk i kushton shumë një përqafim i ngrohtë përkundrazi ai e pasuron atë, duke i falur qetësi e lumturi. Fëmija që vlerësohet ndihet i lumtur, është i ndërgjegjshëm për detyrimet e tij, punon për të arritur objektivat dhe pranon me lehtësi sugjerimet apo këshillat.


Një gabim tjetër i prindërve gjatë edukimit të fëmijëve është edhe të folurit ashpër, apo ironizimi i sjelljeve të tyre, një gabim fatal i cili sjell pasoja negative afatgjata. Në këtë rast mund të flasim për mungesë të dhembshurisë e butësisë në edukim. Mungesa e tyre e bën fëmijën të ndihet i fyer, i pavlerë, i demoralizuar duke e shtyrë atë të mbyllet në vetvete. Një sjellje e tillë e prindit mund t'i shkaktojë fëmijës pasoja si kokëfortësi, belbëzim, urinim të pavullnetshëm, dhunë dhe agresivitet. Prandaj e nënvizojmë me kujdes rëndësinë e dhembshurisë e butësisë në procesin edukativ të fëmijëve.

Së fundmi edukimi i fëmijës është një art më vete dhe ashtu si çdo degë e artit kërkon të bëhet me dëshirë e pasion, kërkon të dhurohet shumë dashuri. Dhembshuria është çelësi magjik në edukimin pozitiv të fëmijëve tanë. Ndryshimi thelbësor i edukimit pozitiv nga edukimi negativ qëndron te ndjenja e dhembshurisë. Le të mos harrojmë se një fjalë e ngrohtë, një përqafim, një përkëdhelje lë më shumë gjurmë dhe ndikon më pozitivisht te fëmija sesa një kritikë apo qortim, i cili mund të lërë gjurmë të padëshiruara.

Ne jemi mbartës të amanetit të cilin nuk e mbajtën as toka e as malet. Si mbartës të tij na takon të edukojmë sipas parimeve të larta të fesë islame, sipas parimeve të paqes, dashurisë e solidaritetit. Nëse ne edukojmë në këtë mënyrë të jeni të bindur se edhe fëmijët tanë do të jenë pasqyrim i kësaj dhe do të jenë individë të një shoqërie me vlera të larta morale. Butësia dhe dhembshuria e lartësojnë njeriun, e zbukurojnë sjelljen dhe e pasurojnë shpirtin e tij.

Lus Allahun e madhëruar që të na i kthejë shpirtat në kopshte dhembshurie, të mos na heqë buzëqeshjen nga fytyrat tona dhe të na dhurojë fëmijë të mbarë!

NË KËRKIM TË NJË VAKSINE PËR COVID - 19



Ka kaluar mbi gjysmë viti që kur Covid-19 përfshiu të gjithë botën dhe detyroi shumë vende të futen në karantinë. Shpresat për një zgjidhje të shpejtë të kësaj sëmundje në shumë vende, që nga ajo kohë, kanë rezultuar, për fat të keq, të kenë qenë të gabuara, dhe është e qartë se virusi është këtu për të qëndruar edhe për shumë kohë [1]. Virusi është kaq i vështirë për t'u trajtuar duke marrë parasysh se ai mund të transferohet nga personi në person edhe nëse transportuesi nuk shfaq simptoma të jashtme. Edhe kafshët, duke filluar nga minjtë deri te tigrat, mund të infektohen dhe t'i

transmetojnë atë njerëzve [2, 3] dhe ne nuk mund t'i fusim në karantinë ose t'i detyrojmë kafshët të mbajnë maska fytyre. Virus përfundimisht do të godasë çdo person, është thjesht çështje kohe. Virus gjithashtu mund të mbërrijë në valë të shumta, pasi është e mundur që një person, pas infektimit të parë, të infektohet përsëri [4]. COVID-19 ka shumë të ngjarë të ketë një jetëgjatësi prej disa vitesh, ashtu si shpërthimet e tjera të mëdha të viruseve në të kaluarën, të tilla si gripi i derrit në Hong Kong ose gripi spanjoll. Ndoshta do të vijë dhe shkojë si një grip i zakonshëm në valë të pafundme që përsëriten. Pra, secili prej nesh duhet të jetë i gatshëm derisa të zhvillohet një vaksinë e suksesshme dhe veprimi më i mençur për secilin nga ne do të ishte ruajtja dhe forcimi i sistemit tonë imunitar dhe praktikimi i masave efektive të distancimit social dhe higjienës, ndërsa përballemi me këtë virus që nuk dimë ende sa mund të zgjasë.

Vaksinat janë të një rëndësie kritike për pengimin e zhvillimit dhe përhapjes së virusëve, megjithatë, ato mund të jenë të kushtueshme, të kërkojnë shumë kohë për t'u prodhuar dhe jo gjithmonë janë të përsosura. Për këtë ja vlen të eksplorohehen metoda alternative për të ndihmuar mbrojtjen e trupit tonë nga këta agjentë patalogjikë, ndërkohë që vaksinat janë duke u hulumtuar. Ndërsa ndodh kështu, metoda më e mirë e parandalimit deri më tani për infeksionet e HIV nuk është vakcina, por në vend të kësaj është një traditë e vjetër, disa mijëra vjeçare, rrethprerja e meshkujve [5]. Për të bërë një krahasim, vakcina aktuale e popullarizuar dhe shumë e promovuar e gripit konsiderohet vetëm "50% efektive kundër virusëve të gripit B / Victoria dhe 37% efektive kundër gripit A (H1N1)" [6]. Nga ana tjetër, sipas një artikulli të botuar në revistën prestigjioze mjekësore "The Lancet" rrethprerja është deri në 88% efektive në parandalimin e transmetimit heteroseksual të HIV [7]. Rrethprerja e meshkujve nuk ka ndonjë efekt anësor dhe rreziqet e vetme që përfshihen janë ato që lidhen me ndonjë komplikim të vogël të ndërhyrjes kirurgjikale siç është gjakderdhja ose infeksioni.

Në vitet '80, kur dëgjova për herë të parë për HIV, mbaj mend të lexoja artikuj që pretendonin, me mjaft arrogancë, se vaksinat dhe kurat për këtë sëmundje do të gjendeshin brenda dy ose tre viteve [8]. 40 vjet më vonë dhe pasi kemi shpenzuar miliarda dollarë për kërkime, ne ende nuk jemi askund pranë gjetjes së një vaksine për HIV. Në rastin më të mirë, ne kemi gjetur trajtime të cilat ndihmojnë për të mbajtur nën kontroll virusin HIV [9]. Deri më tani, vetëm dy persona janë shëruar plotësisht, me një metodë tepër të shtrenjtë për t'u zbatuar në publikun e gjerë [10]. Ndërkohë, të paktën 30 milion njerëz kanë vdekur me më shumë se gjysmë milioni vetëm në vitin 2019 [11]. Ndërsa vaksinat janë të një rëndësie kritike për të ndihmuar në çrrënjosjen e virusëve, vendosja e të gjitha vezëve tona vetëm në atë shportë mund të jetë një strategji e rrezikshme e shëndetit publik, për shkak se sa të vështira dhe kohë kërkojnë të zbulohen, verifikohen dhe shpërndahen. Është e pamundur të dihet me siguri se sa kohë do të duhet për të zhvilluar një vaksinë për koronavirusin. Ndërkohë, komunitetet duhet të marrin shumë në konsideratë ndjekjen e udhëzimeve zyrtare të shëndetit publik që shpesh përfshijnë distancimin shoqëror, mbledhjet me përmasa të kufizuara dhe larjen e shpeshtë të duarve pasi këto metoda tashmë janë provuar se ndihmojnë në zvogëlimin e përhapjes së virusit.

Zhvillimi, madje dhe zhvillimi i shpejtë i një vaksine, është gjithmonë një proces shumë i lodhshëm dhe i rrezikshëm. Shkenca që qëndron pas tyre është jashtëzakonisht e ndërlikuar dhe rezultatet e papërsosura mund të sjellin pasoja katastrofike mbi mijëra njerëz. Kjo ndërlikohet edhe më shumë nga fakti se provat e fazës 2 dhe fazës

3 mund të kenë rezultate mjaft të ndryshme [12]. Në SHBA, provat e vaksinave COVID-19 të AstraZeneca u ndaluan pasi pjesëmarrësit në provë u sëmurën [13]. Provat e fazës së tretë, të cilat përfshijnë mijëra njerëz [14], ende mund të japin pak tregues të efekteve anësore afatgjata për çdo vaksinë. Përveç kësaj, edhe pse ekziston rreziku për jetën njerëzore, vakcina është bërë tashmë një instrument për shumë mosmarrëveshje politike, ekonomike dhe teori konspirative. Disa qeveri pretendojnë se ata kanë zhvilluar tashmë një vaksinë, ndërsa të tjerat i konsiderojnë ato jo të besueshme, ose përpiqen të joshin një kompani të huaj për të punuar për veten e tyre [15]. Në gusht të këtij viti Rusia nxitoi regjistrimin e një vaksine të paprovuar Coronavirus dhe e quajti atë, në mënyrë të ngjashme me Luftën e Ftohtë, "Sputnik V" [16]. Njoftimi u bë nga askush tjetër përveçse nga vetë Vladimir Putin. Ajo u ofrua në SHBA, por u refuzua për shkak të shqetësimeve të sigurisë që buronin nga një besim se ilaçi nuk ishte hulumtuar dhe zhvilluar në mënyrë adekuate [17]. Ndërkohë, Rusia njoftoi zhvillimin e një vaksine të dytë [18]. Me mjaft siguri, ajo u hodh poshtë dhe u minimizua nga Perëndimi si e paprovuar dhe jo e besueshme. Nga ana tjetër, një vaksinë e zhvilluar nga një kompani kineze Sinovac provoi të ishte më e suksesshme në provat e saj të fazës 3 në Brazil [19]. Guvernatori i Sao Paulo João Doria bleu 47 milion doza të vaksinës. Sidoqoftë, transaksioni u ndal, ndoshta për arsye politike, nga Presidenti Brazilian Jair Bolsonaro [20]. Komentet e Bolsonaro, kur refuzoi blerjen e vaksinës Sinovac mbi bazën se "populli brazilian nuk do të jetë "kavje (eksperiment)" e askujt" nuk janë plotësisht pa meritë. Kujtimet e vaksinave të "provuara dhe të testuara" kanë ndodhur edhe në të kaluarën [21].

Është e rëndësishme për të gjithë njerëzit të vazhdojnë të hulumtojnë metodat për të zhvilluar sistemin e tyre imunitar dhe për të parandaluar përhapjen e virusit, ndërsa ne presim për një vaksinë. Në një artikull që kisha botuar më parë, diskutova përfitimet e agjërimit, vitaminës C dhe metodave të frymëmarrjes Wim Hof për të ndihmuar në mbrojtjen e trupit nga sëmundjet [22]. Të gjitha këto metoda janë të njohura dhe mjaft beninje në lidhje me efektet anësore, megjithatë ato nuk janë në gjendje të kurojnë Covid-19 ose të parandalojnë përhapjen e tij. Për më tepër, Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve (CDC) ka theksuar shumë praktika përfshirë distancimin shoqëror dhe mbajtjen e maskave të fytyrës jo të ajrosura. Shpresa jonë është që kalimi mbi dhe përtej për të mbrojtur veten dhe fqinjët tanë do t'u japë shkencëtarëve kohën që u nevojitet.

Një mënyrë për t'i dhënë pak më shumë kohë shkencëtarëve është agjërimi. Agjërimi, si rrethprerja, është një traditë e vjetër mijëra vjeçare. Në studimet e fundit, një agjërëm tre-ditor është treguar i vlefshëm për të rivendosur sistemin imunitar të njerëzve të moshuar në nivelin e një njëzet vjeçari [23]. Në këtë nivel aktual

emergjence në botë do të ishte shumë e lehtë të gjesh mijëra vullnetarë të gatshëm për të provuar agjërime tre-ditore mujore dhe / ose për të marrë doza shtesë të vitaminës C, jo si një kurë, por si një mburojë kundër COVID -19. Ky lloj studimi nuk do të përbënte shumë rrezik dhe padyshim që do të ishte shumë kosto-efektiv. Ne mund të hidhemi drejt në fazën e tretë të provave, sepse efektet anësore të agjërimit janë tashmë të njohura. Dhe së fundmi, nëse provohet efektive, marrja e tij nga popullata në përgjithësi do të ishte në thelb pa kosto dhe e disponueshme në të gjithë botën.

Bota jonë ka qenë duke duruar një periudhë të vështirë dhe sfiduese për më se gjysmë viti tani. Koha na ka dhënë aftësinë për të mësuar më shumë rreth virusit, sesi e dëmton trupin tonë dhe si përhapet. Nga ana tjetër, kjo njohuri na ka lejuar ta hulumtojmë atë dhe të zhvillojmë udhëzime efektive sociale për kufizimin e përhapjes së saj. Akoma, ka shumë punë për të bërë. Histeria dhe nxitimi nuk janë të favorshme për prodhimin e një vaksine të plotë, efektive dhe efikase. Duhet të jetë përgjegjësia e çdo qytetari të aftë për të bërë atë që mundet për të mësuar më shumë se si mund të mbrohemi nga virusi dhe kështu të parandalojmë përhapjen e tij edhe më shumë, ndërsa presim një vaksinë.

Përktheu: Erion Sukaj

REFERENCAT

1. <https://www.wukky.org/post/beshear-next-few-weeks-will-be-critical#stream/0>
2. <https://www.washingtonpost.com/science/2020/09/03/coronavirus-deer-mice-spread/>
3. <https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/daily-life-coping/animals.html>
4. <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC7326402/>
5. [https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736\(99\)03421-2/fulltext?_eventldellogin](https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736(99)03421-2/fulltext?_eventldellogin)
6. <https://www.aafp.org/news/health-of-the-public/20200226interimfluve.html>
7. Halperin, D. T., & Bailey, R. C. (1999). Male circumcision and HIV infection: 10 years and counting. *The Lancet*, 354(9192), 1813-5. doi:[http://dx.doi.org/10.1016/S0140-6736\(99\)03421-2](http://dx.doi.org/10.1016/S0140-6736(99)03421-2)
8. <https://www.immunology.org/publications/bsi-reports/60-years-immunology-past-present-and-future/the-hunt-for-hiv-vaccine>
9. <https://www.cdc.gov/hiv/basics/livingwithhiv/treatment.html>
10. <https://www.medicalnewstoday.com/articles/2nd-person-cured-of-hiv-thanks-to-stem-cell-transplant>
11. <https://www.unaids.org/en/resources/fact-sheet>
12. <https://www.fda.gov/media/102332/download>
13. <https://www.usatoday.com/story/news/health/2020/09/09/covid-vaccine-astrazeneca-trial-hold-what-does-mean/5757590002/>
14. cancer.org/treatment/treatments-and-side-effects/clinical-trials/what-you-need-to-know/phases-of-clinical-trials.html
15. <https://www.nytimes.com/2020/03/15/world/europe/coronavirus-vaccine-us-germany.html>
16. <https://www.theverge.com/2020/8/11/21363135/russia-coronavirus-vaccine-unproven-registration>
17. <https://www.techtimes.com/articles/251792/20200814/covid-19-us-says-no-to-russias-vaccine-sputnik-v-saying-theyll-never-use-it-on-monkeys-let-alone-people-vietnam-and-philippines-say-otherwise.htm>
18. <https://abcnews.go.com/Health/wireStory/russia-approves-2nd-virus-vaccine-early-trials-73614460>
19. <https://fortune.com/2020/10/20/covid-vaccine-china-brazil-testing-ground-safest-most-promising-sinovac/>
20. <https://apnews.com/article/virus-outbreak-brazil-state-governments-health-sao-paulo-b7b5b620ba54f402dbf803e26fe6b842>
21. <https://www.cdc.gov/vaccinesafety/concerns/recalls.html>
22. <https://medium.com/@arasweb/surviving-the-pandemic-370b47120d8d>
23. <https://news.usc.edu/63669/fastig-triggers-stem-cell-regeneration-of-damaged-old-immune-system/>

Ndryshimi i nijetit

Tregohet se profeti Ibrahim a.s. ishte shumë bujar, sa që në çdo vakt ftonte qoftë dhe një person për të ngrënë bashkë. Kur nuk gjente njerëz të njohur, dilte në rrugë dhe ftonte njerëz të panjohur, e rëndësishme të mos hante vetëm.

Njëherë, ai nuk gjeti njerëz e miq për të ngrënë darkë, prandaj dhe doli në rrugë, ku takoi një të moshuar. Menjëherë e ftoi për darkë me fjalë që tregonin respekt dhe vlerësim.

I moshuari edhe pse u çudit nga kjo ftesë, duke parë dashamirësinë e këtij njeriu të panjohur, i shkoi pas.

Pasi u ulën për të ngrënë, profeti Ibrahim a.s. tha: "Bismilah - Me emrin e Zotit" dhe filloi i pari të hajë, me qëllim që t'ia heqë drojën mikut.

I moshuari edhe ai zgjati dorën dhe tha: "Me emrin e zjarrit!"

Ibrahimi u befasua dhe e pyeti: "Po pse nuk fillon me emrin e Zotit, por me emrin e zjarrit?"

I moshuari iu përgjigj: "Sepse zoti im është zjarri, unë i besoj dhe adhuroj zjarrin si zot."

Profeti Ibrahim a.s. u revoltua nga këto fjalë, brofi në këmbë dhe i tha: "Dil jashtë. Ushqehesh me të mirat e Zotit dhe falënderon zjarrin."

I moshuari u largua, ndërkohë Ibrahimit a.s. i flet direkt Zoti duke i thënë: "O Ibrahim! Ka shtatëdhjetë vite që e ushqej me të mirat e Mia, edhe pse nuk më ka falënderuar qoftë edhe një herë. Megjithatë vazhdoj ta ushqej dhe ta furnizoj me begati e mirësi. Ndërkohë, ti për një herë e

dëbove jashtë."

Ibrahimi a.s. doli nga shtëpia dhe iu vu pas të moshuarit derisa e gjeti.

"Më fal, xhaxha. Të lutem kthehu edhe një herë në shtëpinë time që të konsumojmë darkën bashkë.", i tha profeti Ibrahim a.s. i prekur.

I moshuari, i çuditur iu përgjigj: "Ti vetë më ftove dhe po vetë më përzure. Përse u dashka të kthehem përsëri?"

Profeti Ibrahim a.s. i tha: "Kthehu, të lutem, sepse kur të përzura ty, më qortoi Zoti dhe më tha se Ai të furnizonte me të mira gjatë shtatëdhjetë viteve, edhe pse nuk e kishe falënderuar qoftë edhe një herë të vetme."

I moshuari e pyeti: "Pse, Zoti yt u interesoka edhe për mua që adhuroj zjarrin?"

Profeti Ibrahim a.s. iu përgjigj: "Jo vetëm që u interesua, por më qortoi për faktin që të përzura."

I moshuari i tha: "Një Zot që u interesoka edhe për ndjenjat e një të moshuari që nuk e beson, meriton të besohet dhe të adhurohet. Që nga ky moment unë i përkas besimit tënd."

"Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t'ua vënë veshin. Kurse fjala e keqe është si pema e keqe me rrënjë të shkulura, e paqëndrueshme për ekzistencë." (Ibrahim, 24-26)

Një traditë e bukur

Një person tregon: Bashkë me një mikun tim hymë në një kafene të vogël. Pasi bëmë porosinë u nisëm drejt tavolinës. Ndërkohë, dy burra që sapo u futën, iu drejtuan banakierit me këto fjalë:

- Pesë kafe, ju lutem. Dy për ne dhe tre rezervë. Pasi bënë pagesën morën kafetë dhe u larguan. Unë e pyeta mikun tim:

- Çfarë janë këto kafe rezervë?

- Prit dhe do ta shohësh, - u përgjigj ai.

Në kafene u futën disa persona të tjerë. Ata porositën shtatë kafe, tre për veten dhe katër rezervë. Bënë pagesën dhe u larguan. Ndërkohë që po mendoja se çfarë janë këto

kafe rezervë, po shijoja nga dritarja ditën e bukur me diell.

Pas pak, derën e kafenesë e hapi një burrë i veshur me rroba të vjetra dhe që të jepte përshtypjen e një lypsari. Ai i drejtohet me shumë mirësjellje banakierit:

- A keni ndonjë kafe të rezervuar?

Pra është shumë e thjeshtë. Njerëzit paguajnë përpara një kafe, me dëshirën dhe qëllimin e mirë, që dikush i cili nuk ka mundësi të paguajë, të mos privohet nga kafeja e ngrohtë e mëngjesit.

Kjo traditë nisi si fillim në Nepal, por tani po gjen shtrirje në mbarë botën. Madje në disa vende nuk paguhet thjesht një kafe, por dhe një sanduiç apo një vakt i tërë.



BOTIMET KMSH

MUND TA GJENI PRANË LIBRARISË “MIQTË E LIBRIT”



KALENDARI 2021
(1442-1443 HIXHRI)
